


**RAPORT**


**I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Për Programin e Studimit Bachelor 4 vjecar në Psikologji**

**Ofruar nga Universiteti i New York-ut Tiranë**

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. As. Dr. Artemisi Shehu 

Dr. Esmeralda Ismaili 

(Prill/2019)

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Bachelor 4 vjecar në Psikologji**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti i New York-ut Tiranë
2	Fakulteti që e ofron	Fakultetit i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 4201, datë 14.10.2002/ Dekret MASH Nr. 518, datë 20.08.2003. Shkresë MASR Nr. 2160/1, datë 23.03.2018.
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër nr. 384, datë 06.09.2013*
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor 4 vjecar në Psikologji
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	4 Vjet
8	Kreditet në total (ECTS):	256
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Universitetin Shtetëror të New York-ut/Kolegjin Shtetëror të Empire (ESC)
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Diplome e dyfishtë UNYT/SUNY
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6 (Gjashtë)
16	Numri i Studentëve	30 Studente

*\*Me këtë urdhër është akredituar si Master Profesional në Psikologji.*

*Am*

*[Signature]*



## HYRJE

### Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Psikologji

(Të dhëna zyrtare për hapjen e programit të studimit, miratimin e hapjes, akreditimin e parë, etj.)

Programi i studimit 4 vjeçar Bachelor në Psikologji u licencua me Dekret të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Shqipërisë me Nr. 518, datë 20.08.2003. Ky dekret ishte zgjerim i licencimit me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 4201, datë 14.10.2002 për programin e studimit Bachelor 4 vjeçar në UNYT. Programi Bachelor në Psikologji është shpallur i akredituar me Urdhëresë të MASH Nr. 285, dt. 10.10.2006 (sipas relacionit të Këshillit të Akreditimit, datë 08.06.2006 “Mendime dhe Rekomandime për Akreditimin e disa diplomave të Universitetit të New York-ut Tiranë” (UNYT).

Programi studimit Bachelor 4 vjeçar është riorganizuar nga BSc në MP me Shkresë nga MAS me Nr. 6858/2 prot, datë 06.05.2011. Programi MP është akredituar me Urdhër nr. 384, datë 06.09.2013. Programi riorganizohet si Bachelor, me 256 ECTS, me kohëzgjatje 4 vite studimi, me shkresë të MASR Nr. 2160/1, datë 23.03.2018.

### GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. As. Dr. Artemisi Shehu dhe Dr. Esmeralda Ismaili, si eksperte të jashtme vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Kordinatori Teknik i ASCAL, Z. Erjon Xhako.

Më datë 19.03.2019 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 25.03.2019, Institucioni ktheu përgjigje në formë zyrtare në lidhje me Draft Raportin, ku shprehet se **nuk ka komente** në lidhje me të.

Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



## **ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË**

### **I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit**

Në përfundim të procesit të parë të akreditimit me Vendim Nr. 508, datë 18.07.2013, Këshilli i Akreditimit ka dhënë rekomandimet e mëposhtme:

- a) Të bëhet më shumë përpjekje për të rritur më shumë numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimit.
- b) Të realizohen partneritete me ushtrues të profesionit të psikologjisë për të sjellë larmi në formimin e studentëve .

### **II. Plotësimi i tyre nga Institucioni**

- a) Për rekomandimin: **Të bëhet më shumë përpjekje për të rritur më shumë numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimit**, institucioni ka intensifikuar përpjekjet për të shtuar numrin e studentëve duke ndërmarrë disa aktivitete të tilla si: takime me maturantë të shkollave të arsimit të mesëm në Tiranë dhe në rrethe të tjera, promovimin e programit duke përdorur media sociale, audio-vizive dhe nëpër panairë të edukimit brenda dhe jashtë shtetit, shpërndarjen e fletëpalosjeve, takime informuese, etj. Të dhënat statistikore për numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi tregojnë se ka shtim të numërit të studentëve që nga periudha e akreditimit të fundit, kështu nga 11 studentë në vitin akademik 2012-2013 në vitin aktual akademik 2018-2019 numri i studentëve ka shkuar 30. Ashtu sikurse pranohet edhe nga dekania e fakultetit dhe drejtuesi i departamentit që ofron këtë program studimi, numri i studentëve të regjistruar për herë të parë mbetet i ulët. Megjithatë, institucioni ka në vëmendje të punojë në drejtim të shtimit të kontigjentit të studentëve, duke ruajtur edhe cilësinë, mesataren në hyrje të studentëve, që nuk është më pak se 7.
- b) Për rekomandimin: **Të realizohen partneritete me ushtrues të profesionit të psikologjisë për të sjellë larmi në formimin e studentëve**, institucioni ka rritur numrin e bashkëpunimeve me etnitete të ndryshme të profesionit të psikologut siç janë: Urdhri i Psikologut, Bashkia e Tiranës, World Vision, Qendra Spitalore “Nënë Tereza”, etj., duke i dhënë më shumë alternativa studentëve të këtij programi të zhvillojnë praktikat e tyre profesionale. Në RVB shprehet se IAL ka bërë përpjekje për të shtuar në numër si staf akademik efektiv ose me kontratë anëtarë me ekspertizë në psikologji. Por nga shqyrtimi i DVV shihet se në këto vite ashtu sikurse edhe në vitin aktual stafi akademik me këtë profil është i limituar, vetëm tre pedagogëve me gradën shkencore “Doktor”, të cilët kanë ekspertizë në fusha të ndryshme të psikologjisë janë të angazhuar si staf akademik efektiv në këtë vit akademik.



# ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit BSc Psikologji në UNYT në dy vitet e fundit akademike (2017-2018 dhe 2018-2019) ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale, Fakultetit i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Para këtyre viteve, ky program ka qenë pjesë e Departamenti të Shkencave Humane dhe Shkencave Sociale, në Fakultetin e Drejtësisë, Artit dhe Shkencave ofruar si program studimi Master Profesional në Psikologji.

Ky program funksionon pandërprerë që prej vitit 2003. Programi i studimit BSc Psikologji vazhdon të funksionojë në bashkëpunim me State University of New York/Empire State College (ESC). Sikurse pasqyrohet në RVB dhe në dokumentacionin përkatës, kjo mundëson që studentët të pajisen me dy diploma, përkatësisht një nga secili prej universiteteve.

Programi i studimit BSc Psikologji në UNYT ka si qëllim kompletimin e studentëve me kompetenca profesionale dhe personale; me njohuri dhe aftësi në orientime të ndryshme të fushës së psikologjisë, si psikologji sociale, klinike, organizacionale, etj. Kjo perspektivë e programit të studimit sikurse shprehet në RVB krijon mundësinë që studentët të jenë të orientuar qartazi në përzgjedhjen e karrierës së tyre të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.

Ky program studimi ka objektiva të mirëpërcaktuar që synojnë të arrihen siç janë: përgatitja e studentëve me njohuri dhe aftësi bazë mbi aspektet e ndryshme të zhvillimit dhe psikopatologjisë, të cilët do të jenë në gjendje që t'i përthyejnë ato në kontekste të ndryshme; të përgatisë profesionistë që janë të aftë të bashkëpunojnë dhe komunikojnë si dhe të jenë të përgatitur për të kontribuar në zhvillimin e shkencës së psikologjisë.

Kurrikula e këtij programi studimi është hartuar mbështetur në sistemin amerikan të edukimit dhe përditësohet duke u konsultuar me universitetin partner State University of New York/Empire State College. Kjo e dhënë mbështetet në shqyrtimin e dokumentacionit mbështetës të dosjes së vetvlerësimit të programit. Më konkretisht, plan prgramet, syllabuset dhe korrespondenca për përditësimin/ndryshimin e lëndëve me këtë institucion.

Shërbimet mbështetëse për studentët të tilla si qendra e mbështetjes akademike, qendra e këshillimit, etj ofrojnë një mundësi shumë të mirë për të ndihmuar studentët të zhvillojnë edhe aftësi të tjera, të cilat do t'ua lehtësojnë përfshirjen e tyre në tregun e punës në të ardhmen, sikurse janë aktivitetet me natyrë humanitare apo sipërmarrëse. Më konkretisht, në takimin me përfaqësuesin e Zyrës së Karrierës dhe Alumni u prezantua aktiviteti i Panairit të Punës, që organizohet nga UNYT si një aktivitet ku studentët mund të njihen me mundësi të ndryshme punësimi.



## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve <sup>1</sup>
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit ;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Psikologji është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e IAL (ashtu sikurse parashikohet edhe në Statutin e UNYT). Ai përmban objektiva të qarta që fokusohen në zhvillimin intelektual, krijues dhe personal të studentëve, duke përgatitur profesionistë dhe akademik të ardhshëm në sfera të ndryshme të zhvillimit shoqëror.</p> <p>GVJ konstatoi se IAL disponon një strategji për realizimin e studimit të tregut të punës, por ky program studimi nuk është paraprirë dhe as është shoqëruar me një studim tregu, i cili do të mundësonte vlerësimin objektiv të nevojave të tregut të punës për psikologë, edhe pse studentët që përfundojnë këtë program studimi duhet të ndjekin studime të mëtejshme për t'u profilizuar.</p> <p>Ashtu sikurse u konfirmua edhe në takimet me GVB informacioni lidhur me kërkesat e tregut të punës vijnë kryesisht nga studentë të diplomuar ose nga burime informale.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Psikologji është i përshtatur me Planin strategjik të UNYT 2018-2022, duke shprehur se synimi është dhënia e njohurive, aftësive dhe beismen e nevojshëm studentëve për të patur sukses në mjedise pune të ndryshme dhe përgatitjen e tyre si qytetarë të aftë të komunitetit botëror.</p> <p>Pjesë e objektivave të programit të ciklit të parë të studimit në Psikologji janë pajisja me njohuri bazë të disiplinave të psikologjisë duke e vënë theksin edhe në metodat e kërkimit shkencor dhe parimet e përdorimit të tyre.</p> <p>Ashtu sikurse shprehet në RVB dhe nga dokumentacioni mbështetës konstatohet se ky program studimi ka në përbërje të tij edhe lëndë specifike që orientojnë studentët e këtij programi të njihen me drejtime të ndryshme të fushës së psikologjisë siç janë: psikologjia klinike, psikologjia organizacionale, psikologjia e zhvillimit për fëmijë, adoleshentë, etj.</p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave</p>	<p>Në RVB shprehet se UNYT vlerëson nevojat e tregut të punës nëpërmjet studimit të tregut të punës, ku përfshihen profilet e kërkuara nga tregu, kërkesat specifike për profesionin e psikologut dhe parashikon numrin e studentëve që do të regjistrohen në këtë program duke konsideruar programet e ngjashme në institucionet simotra.</p>

<sup>1</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

*Am*

*BT*



<p>të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Në dokumentacionin mbështetës por edhe nga takimi me grupin e punës të ngritur për vlerësimin e këtij programi u konstatua se nuk ka një studim tregu të ndërmarrë nga institucioni, duke pranuar vështirësinë e realizimit të një studimi të tillë. Megjithatë, institucioni ka hartuar një strategji për realizimin e studimit të tregut, në të cilin përshkruhen çështjet që duhet të adresohen nga skuadra e kërkimit shkencor apo agjencia e kërkimit që mund të kontaktohet për ta realizuar atë.</p>
<p><b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Vërtetohet se programi i studimit Bachelor në Psikologji është i përshtatur me zhvillimet dhe vlerat europiane dhe amerikane, ndihmon në ruajtjen e vlerave shqiptare, duke kombinuar literaturën akademike ndërkombëtare me atë kombëtare.</p> <p>Po ashtu, në strategjinë e IAL është shprehur domosdoshmëria e ruajtjes së vlerave kombëtare.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Programi i studimeve Bachelor në Psikologji është hartuar në përputhje me misionin dhe strategjinë e institucionit. Ky program studimi reflekton objektiva të shprehura qartazi dhe në koherencë me zhvillimet më të fundit të disiplinës së psikologjisë, duke i përshtatur me vlerat kulturore kombëtare. Programi i studimit nuk mbështetet në një studim tregu të mirëfilltë, edhe pse IAL ka hartuar një strategji për ta realizuar atë. <i>Sugjerohet që UNYT ashtu sikurse përshkruhet në strategjinë e studimit të tregut të punës, të ndërmarrë studimin e tregut të punës për të vlerësuar nevojat për profilin e psikologut, mund të konsiderohet edhe bashkëpunimi me IAL të tjera të Shqipërisë.</i></p>	

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale përbëhet nga dy departamente dhe qendër kërkimore: Departamenti i Drejtësisë dhe Disiplinave Humane, Departamenti i Shkencave Sociale dhe Qendra Kërkimore e Shkencave Sociale dhe drejtohet nga Dekani i Fakultetit. Dekani koordinon veprimtarinë e njësisë bazë dhe organeve kolegiale të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre. Gjithashtu ai është përgjegjës për koordinimin e veprimtarive të njësisë bazë dhe organeve kolegiale të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre, promovon teknikat e përditësuara në mësimdhënie të personelit akademik të Fakultetit, krijon lehtësirat e nevojshme për një komunikim efikas midis studentë dhe përmbush të tjera të drejta dhe detyrime të përcaktuara në rregulloren e fakultetit

Departamentet dhe qendrat kërkimore kanë shtatë anëtarë me kohë të plotë, ku secili departament ka së paku tre anëtarë efektivë me gradën shkencore “Doktor” ose titull akademik. Krahas anëtarëve efektiv, departamentet kontaktojnë dhe personel akademik me kontrata, veçanërisht për profesionistë në fusha specifike. Konkretisht, ashtu sikurse shprehet edhe në RVB, në



Departamentin e Shkencave Sociale, ku ofrohet edhe ky program studimi, në vitet e fundit është mbështetur kryesisht në personel akademik efektiv, ku të gjithë anëtarët janë të paktën me gradën shkencore "Doktor". Stafin efektiv dhe ai me kontratë, në një masë të madhe është i angazhuar në mësimdhënie pranë këtij departamenti prej një periudhe kohore të gjatë, ku ka pedagogë me mbi 10 vjet angazhim në këtë IAL.

Departamenti i Shkencave Sociale ofron 3 programe studimi: Bachelor në Psikologji, Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare /Shkenca politike dhe Master Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare. Programet e ofruara nga ky departament janë të koordinuara me lëndët e ofruara në programe të departamenteve të tjera, si ato të departamenteve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit dhe Fakultetit të Informatikës.

Mësimdhënia dhe aktivitetet shkencore të fakultetit mbështeten edhe nga njësi të tjera siç janë njësi administrative dhe ajo ndihmëse akademike. Zyra të tilla si: Zyra e Pranimi të Studentëve, Zyra e Menaxhimit të Projekteve, Zyra e Mbështetjes me Teknologji Informacioni, Zyra e Karrierës dhe Çështjeve Studentore, Qendra e Matematikës, Qendra e Shkrimit Akademik, Qendra e Këshillimit dhe Mbështetjes Akademike operojnë në nivel institucioni brenda kuadrit ligjor në nivel kombëtar dhe mbështetur në Statutin e IAL, ofrojnë gjithashtu mbështetje për Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale.

Departamenti i Shkencave Sociale ka gjithsej të angazhuar një staf akademik prej 10 anëtarësh, nga të cilët 7 janë PAE dhe 3 janë PAK. Nga PAE, një është me gradën Prof., një është Prof. Asoc. Dr., pesë PAE janë me gradën Dr. Nga PAE vetëm tre kanë formim në Psikologji, pjesa tjetër i përkasin profileve të tjera, si juridik, marrëdhënie ndërkombëtare, sociologji, etj. Personeli akademik i deklaruar në RVB kuadronte me kontratat e vlerësuara në Zyrën e Burimeve Njerëzore.

Ashtu sikurse përshkruhet në DVV, në dokumentacioni mbështetës dhe në takimi me grupin e vlerësimit të brendshëm diversiteti i formimeve akademike të stafit të angazhuar në departament i dedikohet natyrës së programeve të studimit që ofrohen nga departamenti, ndërsa në këtë program studimi i dedikohet specifikës së programit sipas sistemit amerikan, ku ka një numër të konsiderueshëm lëndësh në disiplina të formimit të përgjithshëm (A) dhe lëndëve me zgjedhje. Për këtë program studimi bashkëpunon me departamente të tjera të IAL për të mundësuar zhvillimin e veprimtarive mësimore të parashikuara për të.

Programi i studimit Bachelor në Psikologji ka në strukturën e tij edhe këshillin shkencor të përbërë nga 3 anëtarë me gradën "Doktor", me kualifikim në fushën e Psikologjisë. Po ashtu njëri prej anëtarëve është dhe Koordinator i Programit BSc në Psikologji (Anekse, Tabela 4).

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale përbëhet nga 2 departamente dhe qendër kërkimore:

1. Departamenti i Drejtësisë dhe Disiplinave Humane
2. Departamenti i Shkencave Sociale
3. Qendra Kërkimore e Shkencave Sociale

Në "Universitetin e New York-ut, Tiranë", sipas strukturës akademike, Fakulteti drejtohet nga Dekani i Fakultetit, ndërsa çdo departament dhe qendër kërkimore drejtohet nga Drejtuesi i



Departamentit dhe Drejtuesi i Qendrës, respektivisht, brenda fakultetit miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi sipas propozimeve të departamenteve përkatëse dhe/ose qendrave, të cilat hartohen në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore.

Departamenti/Qendra është njësi bazë akademike për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Departamenti, si një njësi akademike bazë, vlerësohet periodikisht. Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë.

Drejtuesi i njësisë bazë është përgjegjës për të gjithë veprimtaritë e njësisë. Ai ka përgjegjësi për përpilimin dhe promovimin e drejtimit strategjik të departamentit mbi bazën e planit strategjik të njësisë, zhvillon dhe menaxhon instrumenta për konsultimin, vendimmarrjen dhe komunikimin me gjithë stafin akademik të njësisë bazë, garanton se menaxhimi dhe detyrat akademike e administrative të departamentit shpërndahen në mënyrë të drejtë që të mundësohet zhvillimi i njohurive dhe ngritja e kapaciteteve akademike; përgatit programin e lëndëve dhe të ngarkesës mësimore të pedagogëve të departamentit; mbikëqyr aktivitete të kërkimit dhe të mësimdhënies, si edhe aktivitete të tjera ndëruniversitare duke siguruar arritjen e objektivave dhe cilësisë; projekton nevojat e departamentit për burime njerëzore; promovon përvojat më të mira të mësimdhënies për personelin akademik dhe shërbimeve të nevojshme për studentët në përputhje me kuadrin ligjor të miratuar si dhe kryen procedura periodike të vlerësimit të performancës së personelit akademik mbi bazën e sistemit të sigurimit të cilësisë si dhe motivimit e kualifikimit të vazhdueshëm.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Stafi akademik i Departamentit të Shkencave Sociale është i përbërë nga 7 PAE dhe 3 PAK (Shiko Aneksë, Tabela 1 dhe Tabela 2).

Në programin Bachelor në Psikologji, për vitin akademik aktual 16 PAE dhe 2 PAK.

Procesi i rekrutimit të personelit akademik realizohet me anë të aplikimit përmes njoftimeve në faqen zyrtare të internetit të IAL, shpërndarjen e fjalës për pozicione të lira e deri në kontakte të drejtpërdrejta me personelin akademik në aktivitete të ndryshme akademike dhe shkenocre. Në RVB, në takim me Drejtuesen e departamentit, takim me GVB si dhe takim me vetë stafin u konfirmua kjo mënyrë e rekrutimit të stafit në bazë të nevojave të vetë departamentit si dhe vetë procedura e rekrutimit. Ndërkohë, një anëtar i stafit deklaroi se ishte rekrutuar gjatë një aktiviteti shkencor të organizuar midis IAL dhe partnerëve të tjerë. Vëmendje e veçantë në rekrutim i kushtohet ekspertizës pedagogjike dhe kërkimore, cilësia e arsimimit, përodrimi akademik i gjuhës angleze. Madje kriteri i gjuhës angleze konsiderohet edhe si një pengesë për të thithur staf akademik për profilin e psikologjië, duke sjellë si rezultat numrin e ulët të personelit akademik të profilizuar në drejtime të ndryshme të psikologjisë.

Duke filluar nga viti akademik 2017-2018, Programi i Studimeve Bachelor është pjesë e Departamentit të Shkencave Sociale. Të dhënat më poshtë prezantohen për këtë departament

Viti akademik 2018-2019 – 7 PAE (1 Prof. Dr; 1 Prof As; 5 Dr) dhe 3 PAK ( 2 Dr; 1 Dr në proc.)

Viti akademik 2017-2018 – 7 PAE (7 Dr) dhe 4 PAK (3 Dr; 1 Dr në proc.)



Bazuar në të dhënat e DVV, dhe në evidencat përkatëse që shoqërojnë këtë Dosje, Staf i Akademik i Departamentit të Humaniteteve dhe të Shkencave Sociale (sikurse ka qenë deri në vitin 2016-2017) dhe Staf i akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor Psikologji ndër vite, paraqitet si më poshtë:

Viti akademik 2016-2017 – **7 PAE** (1 Prof As; 4 Dr; 2 Dr në proc.) dhe **7 PAK** (1 Prof. Asoc, 4 Dr; 2 Dr në proces).

Viti akademik 2015-2016 – **7 PAE** (1 Prof As; 3 Dr; 3 Dr në proc.) dhe **14 PAK** (1 Prof. Asoc, 11 Dr; 2 Dr në proces).

Viti akademik 2014-2015 – **8 PAE** (1 Prof. Dr; 5 Dr; 1 Dr në proc. 1 M.Sh) dhe **12 PAK** (1 Prof. Dr, 1 Prof. Asoc, 6 Dr; 3 Dr në proces; 1 M.Sh).

Viti akademik 2013-2014 – **9 PAE** (1 Prof Dr; 2 Prof.Asoc.Dr, 4 Dr; 1 Dr në process; 1 M.Sh) dhe **24 PAK** (1 Prof. Dr, 2 Prof. Asoc, 13 Dr; 2 Dr në process; 6 M.Sh).

Në Departamentin e Shkencave Sociale asistojnë 23 anëtarë në cilësinë e personelit administrativ.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Takim me Drejtuesin e Departamentit përgjegjës
- Takim me Dekanen e Fakultet
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm
- Dokumenti i procedurave dhe kriterëve të përzgjedhjes
- Statuti i IAL
- Rregullore e Studimeve Bachelor 2017-2022

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Nga të dhënat e RVB dhe nga takimi me stafin akademik u vu re se personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi përbëhet nga pedagogë që japin lëndët e specializuara në psikologji dhe pedagogë që japin lëndët e formimit të përgjithshëm dhe lëndë me zgjedhje. Nga të dhënat e paraqitura në DVV dhe nga shqyrtimi i CV si dokumentacion mbështetës, pedagogët që japin lëndët e specializuara në psikologji kanë grada shkencore Doktor ose PhD nga universitete perendimore dhe një eksperiencë të gjatë në kërkim shkencor dhe në praktikimin e profesionit të psikologut. Në këtë program studimi, duke iu referuar RVB dhe takimeve me drejtuesin e departamentit, GVB dhe stafin akademik të departamentit, në vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 18 pedagogë, nga të cilët 16 janë PAE dhe 2 PAK, duke siguruar mbulimin e ngarkesës së mësimdhënies në masën mbi 70%. Personeli akademik me kontratë ka eksperiencë në



mësimdhënie dhe në profilin profesional që atë drejtojnë. Njëri prej tyre vjen nga profili i psikiatrisë dhe anëtarja tjetër ka eksperiencë në mësimdhënie dhe e profilizuar në fushën e biologjisë.

Në DVV si dhe në takimet e zhilluara me drejtuesin e njësisë dhe dekanen e fakultetit u deklarua se departamenti ka bërë përpjekje të shtojë numrin e personelit akademik të specializuar në fushën e psikologjisë, por numri i personelit akademik në këtë mbetet i kufizuar duke konsideruar numrin e veprimtarive akademike specifike për këtë program studimi. Pavarësisht se në DVV deklarohet se raporti i stafit akademik në krahasim me numrin e studentëve në çdo vit është në një mesatare 1 pedagog për 8 studentë dhe se ngarkesa për stafin akademik efektiv është e arsyeshme, mesatarisht nëntë orë në javë, *departamentit i nevojitet të konsiderojë shtimin e personelit akademik me profil në psikologji, për t'i paraprirë shtimit të numrit të studentëve të regjistruar në këtë program (rekomandim ky i dhënë edhe nga akreditimi i mëparshëm).*

IAL UNYT ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit akademik. Kjo procedurë është e përcaktuar në një dokument të veçantë që është pjesë e DVV dhe po ashtu u konfirmua dhe nga takimi me përfaqësuesen e Zyrës së Burimeve Njerëzore. Inicimi i procedurës së rekrutimit vjen nga Drejtuesi i njësisë dhe/ose Dekani. Rektori ose një përfaqësues tjetër i caktuar kërkon aprovimin e buxhetit nga Administratori i IAL. Me të marrë aprovimin, rektori krijon një memo të brendshme, ku përfshihen të gjitha detajet e shpalljes së pozicionit për personel akademik, duke filluar me kualifikimet e nevojshme e deri në përcaktimin e pagesës mujore. Memo firmoset nga rektori dhe Administratori i IAL dhe i dërgohet Menaxherit të Burimeve Njerëzore që përgatit shpalljen e pozicionit të lirë të punës, duke përdorur median e shkruar, vizive dhe faqen zyrtare të internetit të IAL. Aplikimet shqyrtohen nga komisioni i përcaktuar *ad hoc* prej tre anëtarësh për këtë detyrë dhe përgatitej lista e shkurtuar, me të cilët zhvilloheshin intervistat e mëtejshme nga po i njëjti komision. Marrëdhënia e punës së stafit akademik, si efektiv ashtu edhe me kontratë, rregullohet përmes kontratës së punës. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore, pas verifikimit të dosjeve (tre pedagogë efektiv dhe dy pedagogë me kontratë në programin e studimit) u konstatua se dosja përmbante: kontratë me afat të pacaktuar, në të cilën përcaktoheshin lëndët dhe ngarkesa totale e angazhimit, si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet të përcaktuar në Kodin e Punës së RSh; CV, fotokopje e ID; letër pranimi, librezë shëndetësore, llogaria bankare, diploma e doktoraturës, leja e punëdhënësit (rasti i pedagoges S.DH kur ishte PAK), raporti mjekësor, vërtetim i gjendjes gjyqësore, letra e aplikimi.

Kriteret kryesore të aplikuara lidhur me rekrutimin e stafit akademik, të cituara në RVB, të deklaruara nga anëtarë të stafit akademik dhe të konfirmuara nga verifikimi i dosjeve të pedagogëve në Zyrën e Burimeve Njerëzore, ishin:

- Niveli dhe cilësia e arsimit (Master apo Dr., dhe ku është marrë)
- Përvoja e përshtatshme në mësimdhënie dhe/ose kërkim shkencor
- Vjetërsia në pozicionin aktual ose pozicione të kaluara
- Cilësia e kërkimit shkencor
- Filozofia dhe eksperiencia në mësimdhënie
- Orientimi i arsimit dhe eksperiencës në lidhje me misionin e UNYT
- Potenciali zhvillimit të mëtejshëm

Ashtu sikurse përmendet edhe në RVB, por dhe nga takimi me grupin e RVB u konstatua se stafi akademik angazhohet rrallë në mësimdhënie në IAL të tjera, por është më e zakonshme të angazhohen



në aktivitete të tjera profesionale, si rasti i pedagoges S.Dh. e angazhua si anëtare e Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor, të Urdhrit të Psikologut.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat,

Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në Psikologji në vitin akademik 2018-2019 paraqitet si më poshtë:

Viti akademik 2018-2019 – **16 PAE** (1 Prof. Dr; 10 Dr, 1 Dr në proces; 4 M.Sh) dhe **2 PAK** (1 Dr; 1 Dr.proces) (Shiko Anekse, Tabela 5)

Ngarkesa mësimore e stafit të angazhuar në këtë program studimi për këtë vit akademik, përfshirë të dy semestret, mbështetur në dokumentacionin e marrë gjatë vizitës është si më poshtë:

**Dr. E.C.** në cilësinë e PAE është e angazhuar në 6 lëndë, ku njërin prej lëndëve e ndan me Dr.R.T dhe ngarkesa totale shkon në 245 orë.

**Dr. S.Dh.** në cilësinë e PAE është e angazhuar në 5 lëndë brenda këtij programi dhe një lëndë në një program tjetër, ndërsa ngarkesa totale e orëve mësimore është 260 orë.

**Dr. R.T.** në cilësinë e PAE është e angazhuar në 5 lëndë, ku njërin prej lëndëve e ndan me Dr.E.C dhe ngarkesa totale është 270 orë.

**Dr. E.K.** në cilësinë e PAE është i angazhuar në 6 në lëndë brenda këtij programi studimi dhe një lëndë në një program tjetër studimi. Ngarkesa totale e orëve në auditor është 310.

**Dr. E.Sh.** në cilësinë e PAE është e angazhuar në 1 lëndë në këtë program studimi dhe në 4 lëndë në programe të tjera studimi dhe ngarkesa totale shkon 250 orë.

**Dr. R.G** në cilësinë e PAE është e angazhuar në 2 lëndë, ku njërin prej lëndëve e ndan me MSc. M.B dhe ngarkesa totale në orë është 225. Ndërsa **MSc. M.B** është i angazhuar në 2 kurse të tjera në programe të tjera studimi dhe ka një total të ngarkesës prej 225 orësh.

**Dr. S.O** në cilësinë e PAE është e angazhuar në 1 lëndë në këtë program studimi dhe në 3 lëndë në programe të tjera studimi dhe ngarkesa totale është 270 orë.

**Dr. A.E.** në cilësinë e PAE është i angazhuar në 3 lëndë në këtë program studimi dhe në 5 lëndë në programe të tjera studimi. Ngarkesa totale është 365 orë.

**Prof. Dr. F.T.** në cilësinë e PAE është i angazhuar në 2 lëndë dhe në një lëndë në një program tjetër studimi, ndërsa ngarkesa totale është 175 orë.

**Dr. S.L** në cilësinë e PAE është i angazhuar në 1 lëndë në këtë program studimi dhe 7 lëndë në programe të tjera studimi, ndërsa ngarkesa totale është 340 orë.

**MSc S.H, MSc. E.H** dhe **Dr. Proces. M.P** janë të angazhuar në të njëjtën lëndë në këtë program studimi, por kanë ngarkesa në programe të tjera studimi, siç prezantohet dhe më poshtë:

**MSc. S.H** është gjithashtu i angazhuar në 3 lëndë të tjera në programe të tjera studimi me një ngarkesë prej 300 orësh. **MSc. E.H** është e angazhuar në 5 lëndë në programe të tjera studimi dhe ka një ngarkesë prej 285 orësh. Ndërsa **Dr. Proc. M.P.** është e angazhuar në 3 lëndë në programe të tjera studimi dhe ka një ngarkesë prej 255 orësh.

Bazuar në shqyrtimin e ngarkesës në lëndë dhe orë të pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi, të cilët po ashtu janë të angazhuar edhe në programe të tjera studimi (përfshirë Dr. E.C, Dr.S.DH dhe Dr.R.T që janë të angazhuara vetëm në këtë program studimi) konstatohet se disa pedagogë kanë një ngarkesë të lartë në orë, si p.sh. rasti i pedagogëve Dr. A.E, Dr. E.K. Dr. S.L,



MSc. S.H. Po ashtu, duke konsideruar edhe detyrimin kontraktual në aktivitete kërkimore shkencore që stafi akademik efektiv duhet të përfshihet, kjo ngarkesë konsiderohet e lartë. I njëjti konstatim është edhe për stafin akademik të profilizuar në psikologji, që krahas mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, janë të angazhuar edhe në aktivitete të tjera mbështetëse për studentët. Dr. E.C. është njëkohësisht koordinatore e programit dhe këshilluese akademike e studentëve, ndërsa Dr. S.Dh është edhe koordinatore e zyrës së këshillimit psikologjik. Nisur nga çfarë u prezantua mësipër, *shihet e nevojshme shtimi i numrit të pedagogëve të profilizuar në fushën e psikologjisë dhe rishikim i ngarkesës së stafit akademik në raport edhe me angazhimin në programe të tjera studimi të UNYT.*

Mbështetur në Tabelën 5 të Dosjes së Vetvlerësimit, Stafi akademik ndër vite paraqitet:

Viti akademik 2017-2018 – **21 PAE** (1 Prof.Dr; 13 Dr; 2 Dr në proces; 5 M.Sh) dhe **5 PAK** (4 Dr; 1 Dr në proces)

Viti akademik 2016-2017 - **21 PAE** (3 Prof.Dr; 1 Prof. As.; 10 Dr; 2 Dr në proces; 5 M.Sh) dhe **5 PAK** (1 Prof.Dr; 3 Dr; 1 Dr në proces)

Viti akademik 2015-2016 - **22 PAE** (3 Prof.Dr; 2 Prof. As.; 12 Dr; 2 Dr në proces; 3 M.Sh) dhe **6 PAK** (1 Prof. As.; 3 Dr; 1 Dr në proces; 1 M.Sh)

Viti akademik 2014-2015 - **18 PAE** (3 Prof.Dr; 1 Prof. As.; 10 Dr; 2 Dr në proces; 3 M.Sh) dhe **6 PAK** (1 Prof.Dr ;1 Prof. As.; 3 Dr; 1 Dr në proces)

Viti akademik 2013-2014 - **19 PAE** (3 Prof.Dr; 1 Prof. As.; 6 Dr; 1 Dr në proces; 6 M.Sh) dhe **11 PAK** (1 Prof. Dr.; 5 Dr; 1 Dr në proces; 4 M.Sh).

Nga të dhënat e paraqitura në DVV konstatohet se për programin e studimit Bachelor në Psikologji nga viti 2013 deri ne 2019 ka një tendencë në rritje për të shtuar numrin e stafit akademik efektiv dhe për të reduktuar numrin e stafit akademik me kontratë. Kjo do të thotë se gjatë këtyre viteve ngarkesa mësimore është mbuluar në masën mbi 70% nga stafi akademik efektiv, sikurse e parashikon korniza ligjore. Përrjashtim bën vetëm viti 2013-2014 ku kjo masë është pak më poshtë se kjo masë, 63%.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Ashtu sikurse u paraqit edhe më sipër, në programin e studimit Bachelor në Psikologji raporti raporti i PAE/PAK të angazhuar në vitin akademik 2018-2019 është 16/2. (Shiko Anekse, Tabela 5)

Të dhënat sipas seksit

Të dhënat e personelit akademik të klasifikuar sipas seksit janë paraqitur në Anekse, Tabela 3/1.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Bazuar në të dhënat e marra nga DVV klasifikimi sipas moshës i personelit akademik të angazhuar për programin e studimit Bachelor në Psikologji është paraqitur në Anekse, Tabela 3. Ashtu sikurse paraqitet në tabela, mosha e stafit akademik (PAE & PAK) i përket grupmoshës 36- 45 vjeç, kurse mosha mesatare e personelit ndihmës akademik i përket moshave 25-35 vjeç.



- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Në RVB deklarohet se personeli akademik efektiv dhe me kontratë janë të pajisur me kontrata të rregullta të punësimit në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Zyra e Burimeve njerëzore është përgjegjëse për përpilimin dhe mirëmbajtjen e kontratave të punës si për personelin akademik edhe atë administrativ. Në takimin me menaxheren e kësaj zyre na u tha se duke filluar nga muaji Tetor 2018, me blerjen e univeristetit, punëdhënësit e rinj kanë aplikuar një variant të ri të kontratës, e cila është në përputhje me Kodin e Punës dhe Ligjin e Arsimit të Lartë 80/15, kontratat janë me afat të pacaktuar për personelin akademik efektiv dhe me afat të përcaktuar për personelin akademik me kontratë. Kontrata firmoset nga rektori dhe Administratori i IAL. Ashtu sikurse u konfirmua edhe gjatë takimit me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi, kontrata është individuale dhe negociohet për kushtet e përcaktuara personalisht me Administratorin edhe Rektorin e IAL, ata ishin në dijeni të detyrimeve dhe të drejtave të tyre. Në formatin e kontratës si për PAE dhe PAK, krahas detyrimeve dhe të drejtave, përcaktohet edhe ngarkesa mësimore e secilit pedagogë.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Në RVB paraqitet si personel ndihmës akademik 23 anëtarë me grada shkencore: 1 anëtarë është në proces dokotrate, 12 janë me MSc, 4 anëtarë me MP dhe 3 anëtarë kandidatë për MSc. si dhe të dhënat me moshën e stafit.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Takimi me drejtuesin e departamentit dhe dekanen
- Takimi me stafin akademik
- Takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore
- Shqyrtimi i dy model kontratave të punës, për PAE dhe PAK
- Shqyrtimi i dosjeve të punësimit 3 PAE dhe 2 PAK
- Shqyrtimi i dokumentacioni për ngarkesën mësimore te PAE dhe PAK
- Dokumenti i procedurës së rekrutimit
- Shqyrtimi i CV të personelit akademik

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Sipas të dhënave të siguruar nga DVV, takimeve me GVB, personelin akademik, përfaqësues të zyrave ndihmëse dhe menaxheren e zyrës së burimeve njerëzore rezulton se IAL ndjek procedura transparente dhe ligjore për të rekrutuar personelin akademik. Procedurat janë qartësisht të shprehura në Statutin e IAL dhe dokumentin e posaçëm për procedurat e rekrutimit.
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;	Programi i studimit BSc në Psikologji mbulohet në masën mbi 70% nga staf efektiv i IAL, duke koordinuar për lëndët e formimit të përgjithshëm me departamentet e fakulteteve të tjera të IAL UNYT.
<b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	Nga takimet e realizuara me stafin akademik, studentët dhe drejtuesin e njësisë dhe dekanen u konstatua se pedagogët
<b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të	



<p>njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>vlerësohen nga disa burime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimet nga studentët, të cilët pohuan se përpara realizimit të provimit në çdo semestër, pedagogët dalin nga salla dhe ata plotësojnë në mënyrë anonome një formular vlerësimi.</li> <li>- Vlerësimi nga pedagogë të tjerë për kolegët e tyre, me bazë rotacioni, në fillim të çdo semestri, një kolegë merr pjesë në orën e mësimit dhe mban shënime dhe jep sugjerime mbi përmbajtjen e planit të programit, metodën e mësimdhënies, etj.</li> <li>- Vetvlerësimi, pedagogët bëjnë një vlerësim individual të performacës së tyre vjetore</li> <li>- Vlerësimi i kërkimit shkencor, përmes një formati të standardizuar të aprovuar nga çdo fakultet, departamenti bën vlerësimin e punimeve shkencore të stafit akademik.</li> </ul> <p>Rezultatet e vlerësimeve ndahen individualisht me pedagogët në fund të semestrit dhe diskutohet në strukturat e departamentit, fakultetit dhe rektoratit.</p> <p>GVJ konstatoi se zyra e Burimeve Njerëzore ruan një bazë të dhënash për raportet e rekrutimit të personelit, njoftimet, letrat e ofertave të nisura për stafin e rekrutuar, etj.</p>
<p><b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent”.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Sociale si dhe Zyra e Burimeve Njerëzore mbajnë një dokumentacion të hollësishëm, si për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, ashtu edhe për personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit BSc Psikologji, të cilat ishin prezantuar në DVV dhe tabelat përkatëse, si dhe nga takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Kjo zyrë plotëson dhe arkivon dosjet e secilit prej anëtarëve të stafit akademik, me të gjithë elementët përmbajtës të një dosje (përshkruar më sipër). ZBNj mban gjithashtu një dokumentacion të plotë edhe të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ.</p> <p>Në kohën kur konstatohen nevojat për të rekrutuar staf akademik, IAL bën njoftimin përkatës (në faqen zyrtare të IAL dhe në media të tjera) për pozicionet e lira të punës për personel akademik për programe specifike të studimit.</p> <p>Nga të dhënat e prezantuara në DVV, syllabuset e lëndëve në këtë program studimi pjesa më e madhe e titullarëve të lëndëve kanë gradën shkencore Doktor. Më konkretisht në vitin akademik 2018-2019 janë 1 me gradën Prof.Dr, 10 PAE me gradën shkencore Doktor, 1 pedagogë është në proces dhe 4 anëtarë janë me Master Shkencorë, ndërsa nga PAK një është me DR dhe një anëtar është në proces të përfundimit të studimeve doktorale. Edhe në rastin e titullarëve të lëndëve me M.Sh, që janë të disiplinave të formimit të përgjithshme, planprogramet konsultohen me titullarë me grada shkencore, me përgjegjëjësin e programit të studimit, që ka gradën shkencore Ph.D, si dhe me stafin nga universiteti partner SUNY.</p>
<p><b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim</p>	<p>Programi i studimit BSc. realizon orë laboratorike,në</p>



<p>optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>laboratorët e informatikës në lëndët e metodave të kërkimit shkencor dhe statistikës, për programin e përpunimit të të dhënave SPSS.</p> <p>GVJ në takimet e zhvilluara gjatë vizitës me zyrat e ndryshme të IAL UNYT konstaton qasjen pozitive dhe gadishmërinë për të mbështetur stafin akademik dhe studentët për të arritur me sukses objektivat e programit.</p> <p>Personeli akademik i anagazhuar për mentorimin e studentëve në praktikën profesionale është në raport 1 pedagogë për 4-5 studentë. Ky raport i favorshëm për mentorim cilësorë i dedikohet edhe numrit të vogël të studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Dy pedagoge (Dr. E.C dhe Dr. S.Dh) janë mentoret për praktikën profesionale të studentëve të këtij programi. Ndërsa për udhëheqjen e punimit kërkimor final, raporti është 1 pedagogë për 5-6 studentë.</p>
<p><b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Në DVV, dokumentacionin mbështetës si dhe në takimet me GVB dhe personelin akademik u konstatua se IAL ka në vëmendje kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik. Institucioni disponon një buxhet me zëra të përcaktuara për kërkimin dhe zhvillimin akademik. Nga takimi me Zyren e Projekteve dhe Inovacionit u deklarua se IAL ka një fond për të ndihmuar pedagogët të bëjnë kërkime shkencore, me aprovimin e dekanit të fakultetit. IAL ofron mundësi për mobilitet të stafit përmes projekteve të Erasmus +, rasti i pedagoges Dr.S.Dh, në aktivitetin e zhvillimit të IAL në Turqi në vitin akademik 2018.</p> <p>IAL disponon një bazë të dhënash elektronike, Gnomon, në të cilën detajohen programet e studimit, lëndët/modulet, pedagogët, oraret, studentët e regjistruar.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Sipas të dhënave dhe verifikimeve të bëra nga GVJ, personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i Departamentit të Shkencave Sociale angazhohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në përputhje me objektivat e programit të studimit Bachelor në Psikologji. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi disponon kualifikimin e nevojshëm për të përcjellë më profesionalizëm njohurinë dhe praktikën të studentët e këtij programi. Departamenti i Shkencave Sociale është kujdesur që shpërndarja e ngarkesës mësimore të realizohet në masën 70% nga staf akademik efektiv, sikurse parashikon kuadri ligjor.</p> <p><i>Megjithatë, dëshmohej se është e nevojshme shtimi i numrit të pedagogëve të profilizuar në fushën e psikologjisë.</i></p> <p>IAL ndjek procedura transparente për rekrutimin e stafit akademik. Po ashtu edhe të vlerësimit të performancës së pedagogëve të angazhuar në mësimdhënie, duke trianguluar format e vlerësimit të stafit.</p> <p>Institucioni disponon një sistem të informatizuar të ruajtjes së të dhënave, i cili përditësohet periodikisht, por edhe arkivon fizikisht dokumentacionet që lidhen me aktivitete shkencore (Libra abstraktesh, konferenca, etj).</p> <p>IAL dëshmon përkushtim në zhvillimin akademik dhe kualifikime të personelit të angazhuar në këtë program studimi, duke alokuar fonde të posçme dhe vendosur marrëveshje bashkëpunimi për aktivitet promovuese.</p>	

**4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.



IAL UNYT nga vitit 2014 është zhvendosur në një zonë të re të kryeqytetit, kjo edhe për shkak të rritjes së numrit të studentëve që frekuentojnë programet e studimit të tij. Ai është pozicionuar në zonën e Kodrës së Diellit. Ndërtesa më përpara ka funksionuar për shkollë nëntëvjeçare dhe gjimnaz. Qetësia është e ndjeshme, pasi lëvizjet e automjeteve janë të kufizuara për zonën përqark të banimit. Është i vendosur larg qendrës së metropolit dhe kërkon mjet për të arritur, por rruga dhe aksesit janë të pranueshme. Edhe nga verifikimet në vendndodhje por edhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi Evidencën e infrastrukturës, mund të thuhet se mjediset e jashtme janë relativisht me hapësirë, parking të bollshëm, si dhe në pjesën e pasme të ndërtesës ndodhet edhe një palestër kalçeto në përdorim nga institucioni i UNYT. Mjediset e brendshme janë zyra, salla leksioni me rreth 40-60 vende, disa të tilla, dhe me salla më të vogla prej 10-20 studentësh. Gjithashtu ka dhe një sallë për organizime konferencash apo prezantimesh me rreth 90 karrige. Në hapësirën e kalçetos organizohen edhe aktivitete të tjera si ekspozita, shfaqje apo panairë të ndryshme.

Linja Wi-fi e internetit është e shtrirë në zonën që mbulon hapësirat e UNYT.

Institucioni është i kujdesshëm për të kontrolluar edhe sistemin e sigurisë mbi rreziqet si zjarri apo siguria higjienike. Ndërtesa është e pajisur me sistem ngrohje e ftohje dhe ka kushte të kënaqshme mësimdhënëse dhe studimi. Linja elektrike është përhershme edhe për shkak të një gjeneratori të aksesueshëm vazhdimisht.

Biblioteka ka një hapësirë të kënaqshme, ndriçim dhe kushte të qeta për studim dhe hulumtim. E pajisur me disa tavolina për studim dhe me raftë me libra, verifikohen mjaft tituj edhe nga psikologjia. Gjithashtu, u mundësua edhe verifikimi i shërbimit onsite që disponon institucioni. Studentët aksesojnë përmes kodit që pajisen, në faqet e ndryshme me të cilat ka marrëveshje institucioni, siç janë: McGraw Hill, JSTORE, QUESTIA, EBSCO.

Biblioteka ka të dallueshëm orarin e shfrytëzimit të saj, mban një inventar librash, revistash dhe publikimesh të tjera që përditësohen. UNYT ofron dhe programin e Turnitin për qëllime të detektimit të plagjaturës.

Kushtet janë të kënaqshme dhe ofrojnë mundësi për këdo që do të shfrytëzojë bibliotekën e institucionit.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Mjediset për Programin e studimit (Shiko Anekset Tabela 17)

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Korridore/holle
- Mjedise sportive
- Mjedise për aktivitete e qeverisë studentore
- Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj



- Nyje hidrosanitare për studentët
- Parking

Mjediset për stafin: (Shiko Anekset Tabela 17)

- Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik
- Zyrë për financën
- Zyrë për njësinë e SBC
- Salla për mbledhje
- Mjedis për stafin e shërbimit
- Nyje hidrosanitare për personelin akademik

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Infrastruktura dhe facilitetet u verifikuan nga vizita në institucion si dhe nga dokumentet e dorëzuara të institucionit Aneksi mbi Planimetrinë e godinës.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<p><b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b></p> <p><b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Institucioni verifikohet që vendos në ofertë të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse cilësore dhe sasiore. Duke qenë se prej disa vitesh institucioni ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me shtëpinë botuese McGraw-Hill, ai siguron mjaft tekste bashkëkohore në të gjitha programet, për rrjedhojë edhe në programin e BSc në Psikologji. Studentët në çdo fillim semestri pajisen jo vetëm me sylabusin e lëndës por edhe me një kod me të cilin aksesojnë elektronikisht literaturën e detyrueshme dhe ndihmëse nga faqet në internet si :JSTORE, QUESTIA, EBSCO .</p> <p>Literatura është e 10 viteve të fundit.</p> <p>Biblioteka është e pajisur me kushtet e nevojshme për përdorimin e saj, me ndriçim dhe qetësi. Ka orare të aksesueshme nga të gjithë të shpallura si në faqen e internetit të institucionit ashtu edhe përpara zonës së saj. Oraret janë të mbulueshme gjatë gjithë ditës.</p> <p>Në bibliotekë gjenden tituj librash në shqip dhe në gjuhë të huaj anglisht edhe për programin Bsc Psikologji, të viteve të fundit por edhe të mëparshëm. Por biblioteka ofron më shumë literaturë të fundit në tituj elektronikë edhe për shkak të marrëveshjeve të bëra sidomos me SUNY/Empire State College (Ebrary). Kjo është për t'u vlerësuar. Edhe pse marrëveshja për shfrytëzimin online të librave të McGraw-Hill përmban edhe pikën e dorëzimit të një kopjeje të printuar në bibliotekën e UNYT, kjo nuk ka ndodhur deri tani. Sugjerohet të ndodhë, pasi jo vetëm është pjesë e marrëveshjes dhe duhet respektuar, por edhe bëhet si kopje e nevojshme për t'u shfrytëzuar nga studentët dhe jo vetëm. Sugjerohet të realizohet edhe për shtimin e titujve fizikë në institucion si dhe për t'i shërbyer marrëdhënieve insitucionale me institucione homologe</p>



	<p><i>dhe jo vetëm, për të kryer kërkime shkencore të ndryshme.</i></p> <p>Çdo fillim viti akademik edhe pedagogët propozojnë tituj librash që do të donin t'i kishin në formën hard-copy në bibliotekë dhe kjo i mundësohet për lëndën përkatëse.</p> <p>Buxheti i bibliotekës është i verifikueshëm edhe nga dokumenti i Aneksit 28 që parashikon një shifër nga 12'000 në 15'000 Euro në vit për aksesin me McGraw-Hill.</p> <p>Gjithashtu biblioteka ka orare të përshtatshme aksesi e studimi si dhe sistem Wi-fi, së bashku me një sallë kompjuterash që aksesohen nga studentët rreth 20 të tillë. Në mjediset jashtë saj gjenden edhe dy salla të vogla për punë grupi nga studentët.</p> <p>Do të ishte shumë e sugjerueshme gjithashtu bashkëpunimi mes institucionit dhe institucioneve të tjera jo vetëm të arsimit të lartë për vendosjen në aksesueshmëri të bibliotekës kundrejt marrëveshjeve të përfitimit, pasi kjo do t'i hapte rrugën jo vetëm reklamimit më të madh institucional por edhe bashkëpunimeve për kërkime shkencore ndërinstytucionale.</p>
<p><b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Institucioni ka sasi sallash për të mbuluar nevojat e numrit të studentëve në program për të zhvilluar leksione dhe seminare, laboratorë dhe këto janë të pajisur me pajisjet e nevojshme për zhvillimin e mësimdhënies: tabela të bardha, over-projektor, tabela të ndryshme, etj., si dhe ka mbulim të Wi-fi për akses nga të gjithë.</p> <p>Pajisjet e përmendura mësipër por edhe ambientet në të cilat realizohet mësimdhënia mundësojnë zhvillimin e leksionit dhe projekteve të kërkimit në kushte optimale për përthithje dhe asimilim.</p> <p>Vërtetohet nga vizita në institucion se klasat dhe hapësirat janë me ndriçim të mjaftueshëm dhe të përshtatshme për mësimdhënie e mësimnxënie.</p> <p>Për programin e studimit BSc Psikologji, institucioni vë në dispozicion laboratorët e informatikës për lëndët e statistikës dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Në këtë kuadër, vlen për t'u përmendur se thuhet të gjitha pajisjet kompjuterike në salla janë të përshtatshme për të punuar me sistemin e përpunimit të të dhënave SPSS edhe për shkencat sociale. Kompjuterët janë të lidhur me internetin për të mundësuar kërkimin e materialeve të nevojshme nga çdo hyrje.</p> <p>Institucioni zotëron marrëveshje bashkëpunimi me institucione apo subjekte të tjera për zhvillimin e praktikave profesionale, institucioni ka lidhur disa marrëveshje si me Urdhrin e Psikologut, disa qendra spitalore dhe disa banka.</p>
<p><b>Konkluzione të GVJ:</b></p>	
<p>Vendndodhja e institucionit është e pozicionuar jashtë qendrës së Tiranës, por është e aksesueshme nga të gjithë dhe qetësia e akomodimi në të janë të përshtatshme. Përgjithësisht kriteret e aksesueshmërisë janë të kënaqshme për të studiuar edhe student me aftësi ndryshe, pavarësisht se në këtë program studimi nuk ka patur deri tani asnjë student me këto aftësi. Infrastruktura dhe kapaciteti për studim ishin optimal dhe të kënaqshme. Klasat e mësimdhënies dhe studimit janë të pajisura me kushtet e përshtatshme për procesin mësimor. Sa i përket bibliotekës vlerësohet një numër i konsiderueshëm titujsh librash në përgjithësi dhe për programin</p>	



në veçanti. Fakti që studentëve iu vendoset një kod në dispozicion për të patur akses online për literaturë në faqet si JSTOR, QUESTIA, EBSCO dhe McGraw-Hill është një hap me vlerë për të siguruar cilësinë e literaturës më të fundit. Kjo i shërben atyre për të kryer studime dhe detyra kursi. Sugjerohet pajisja dhe shtimi i kopjeve fizike të librave, për të cilat marrëveshja mes UNYT dhe shtëpisë botuese britanike McGraw-Hill ka mundësuar të realizojë meqë pjesë e kësaj marrëveshjeje ishte edhe dorëzimi i një kopjeje fizike në bibliotekën e UNYT, gjë e cila nuk ka ndodhur deri tani.

*Do të ishte e sugjerueshme gjithashtu edhe bashkëpunimi mes institucionit dhe institucioneve të tjera jo vetëm të arsimit të lartë për vendosjen në aksesueshmëri të bibliotekës kundrejt marrëveshjeve të përfitimit, pasi kjo do t'i hapte rrugën jo vetëm reklamimit më të madh institucional, por edhe bashkëpunimeve ndërinstytucionale për kërkime e zhvillim kombëtar e ndërkombëtar.*

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Ashtu sikurse është paraqitur në RVB, burimi kryesor i të ardhurave për IAL UNYT janë të ardhurat nga tarifat e shkollimit, grantet për kërkim dhe kontratat si dhe aktivitetet të tjera tregtare të tilla si shërbimet mbështetëse argëtuese; kafe, mensa, bare, rezidenca, etj.

IAL ka Zyrën e financës që merret me implementimin e politikave financiare, informacioni gjeneruar prej saj përdoret për të mbështetur zhvillimin dhe përballimin e kostove si dhe për të siguruar stabilitet të institucionit. Në fund të çdo viti akademik Universiteti i New York-ut Tiranë kryen analizën e të ardhurave dhe të kostove të programeve të studimit. Analiza e kostove përmban: kosto e mësimdhënies, udhëtimi dhe akomodimi e profesorëve që udhëtojnë nga jashtë vendit, tarifat që u paguhen universiteteve partnere (State University of New York/Empire State College; University of Greenwich,), pagat e stafit mbështetës administrativ sikurse dhe kosto të tjera fikse operationale sikurse qera, energji/telefon/internet etj të cilat janë të lidhura me programet e studimit, kosto të blerjes së aseteve të trupëzuara apo të patrupëzuara të nevojshme për funksionimin e aktivitetit të UNYT, kosto për blerje të licensave të programeve software, licensave të bibliotekave elektronike, etj.

Sa i takon kostove vjetore për çdo student, analiza e kostos shoqerohet edhe me të ardhura që gjenerohen për çdo program. Një analizë fitim/humbje bëhet për programet bachelor në përgjithësi sikurse dhe çdo program M.Sh dhe PhD në veçanti dhe bëhen modifikimet e nevojshme të komponenteve të caktuar të kostos për vitin e ardhshëm akademik. Për vitin akademik 2017-2018, kostoja e studentit për këtë program studimi në vit është 3,442 euro për diplomën e lëshuar nga UNYT dhe për diplomën ESC 4,998 euro.

UNYT kryen auditime të brendshme dhe të jashtme për çdo vit. Auditimi i brendshëm kryehet nga Komisioni i emëruar nga bordi i aksonerëve të UNYT, ndërsa audimi i jashtëm kryehet nga një kompani e pavarur e auditimit shqiptare ("Euro-Audit, Consultancy.co" shpk).

Sipas deklarimeve të shprehura në RVB, UNYT zotëron kapacitet e nevojshme për të zhvilluar procese dhe sisteme efektive të menaxhimit financiar dhe për të përdorur këtë informacion në mbështetje të zhvillimit të programit.

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje) paraqiten në Anekse, Tabela 6.



- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Shpenzimet për studentët përfshijnë shpenzimet operacionale dhe shpenzimet kapitale. Shpenzimet operacionale përfshijnë koston e mësimdhënies, udhëtimi dhe akomodimi e profesorëve që udhëtojnë nga jashtë vendit, tarifatat që u paguhen universiteteve partnere (State University of New York/Empire State College; University of Greenwich,), pagat e stafit mbështetës administrativ sikurse dhe kosto të tjera fikse operacionale sikurse qera, energji/telefon/internet etj të cilat janë të lidhura me programet e studimit ndërsa shpenzimet kapitale përfshijnë koston e blerjes së aseteve të trupëzuara apo të patrupëzuara të nevojshme për funksionimin e aktivitetit të UNYT, kosto për blerje të licensave të programeve software, licensave të bibliotekave elektronike, koston e akreditimit, etj. Për vitin akademik 2017-2018, kostoja e studentit për këtë program studimi në vit është 3,442 euro për diplomën e lëshuar nga UNYT dhe për diplomën ESC 4,998 euro.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Raporti i Auditimit të Brendshëm UNYT
- Raporti i Auditimit të Jashtëm
- Raporti Financiar Vjetor 2017-2018
- Statuti i IAL UNYT

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni, në fund të çdo viti financiar i nënshtrohet një procesi auditimi të brendshëm dhe të jashtëm. Auditimi i brendshëm konkludon në lidhje me arritjen e objektivave financiar, besueshmërinë e raportimit financiar dhe menaxherial dhe pajtueshmërinë me legjislacionin në fuqi. Ndërsa auditimi i jashtëm i kryer nga një kompani e jashtme auditimi konkludon se pasqyrat financiare janë të lira nga gabimet materiale.</p> <p>Raporti i Auditimit synon të bëjë një analizë të plotë të shpenzimeve të realizuara me të ardhurat duke monitoruar zërat e buxhetit dhe shpenzimet e krahasuar me aktivitetin financiar.</p>
<b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b>	
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së</p>	<p>Në përfundim të çdo viti financiar, IAL UNYT harton një raport në të cilin janë të pasqyruara të gjitha koston për realizimin e programit të studimit duke përfshirë: shpenzimet e personelit, shpenzime konsumi dhe amortizimi, shpenzime të universiteteve partnere, shpenzime financiare, shpenzime kapitale, etj.</p> <p>Duke u bazuar në DVV, RVJ konstaton se UNYT disponon raporte financiare në tri vitet e fundit, sic konsiderohen: Raporti Auditimit të Brendshëm 2015-2016, Raporti Vjetor 2017-2018- Pjesa Financiare. Ndërsa për vitin 2018, sikurse përshkruhet edhe në RVB dhe në Shkresën drejtuar ASCAL "Sqarim për pasqyrat financiare</p>



zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

të UNYT për vitin financiar 2018” me Nr.Prot 04/2019, pasqyrat financiare kanë si afat të hershëm dorëzimi, datën 31 mars të vitit pasardhës.

GVJ, bazuar në analizën financiare të bërë nga vlerësues të brendshëm dhe të jashtëm, vlerëson se, UNYT ka qëndrueshmëri financiare gjatë periudhës në të cilën ofrohet programi i studimi.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Vërtetohet se UNYT zotëron kapacitetet e nevojshme për të zhvilluar procese dhe sisteme efektive të menaxhimit financiar dhe për të përdorur këtë informacion në mbështetje të zhvillimit të programit.

Institucioni, në fund të çdo viti financiar i nënshtrohet një procesi auditimi të brendshëm dhe po ashtu një auditimi të jashtëm të realizuar nga një studio auditimi e licensuar. Raporti i Auditimit synon të bëjë një analizë të plotë të shpenzimeve të realizuara me të ardhurat duke monitoruar zërat e buxhetit dhe shpenzimet e krahasuar me aktivitetin financiar, për të mundësuar vijimësinë e sigurt të cilësisë së realizimit të programit të studimeve Bachelor Psikologji.

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në takimet e realizuara konstatohet se IAL paraqet qëndrueshmëri financiare për të mbështetur nevojat e programit të studimit BSc Psikologji.

## **6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sikurse përshkruhet në RVB, sistemi dhe procedurat e Sigurimit të Cilësisë në UNYT janë zhvilluar gjatë 16 viteve të aktivitetit akademik të tij, duke përshtatur praktikat më të mira të partneriteteve institucionale të krijuara, që janë në përputhje me praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në bashkëpunim me KoGaSCI . Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Mbi bazën e pyetësorit studentor dhe të informacioneve të mbledhura ose punimeve të kryera, hartohet raportii vlerësimit vjetor. Raportet e vlerësimeve, të kryera nga NjSBC për sigurimin e brendshëm të cilësisë së UNYT , përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon nga bashkërendimi i punës së gjashtë personave, që përbëjnë Komisionin të Përhershëm të Garantimit të Standardeve të Cilësisë së Institucionit (KoGaSCI), që përbëhet nga një kryetare dhe 4 anëtarë që përfaqësojnë të gjithë fakultetet dhe një studentë si përfaqësuese e studentëve. Zyra e Sigurimit të Cilësisë koordinohet nga një koordinatorë. Ashtu sikurse përshkruhet në RVB dhe në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, si dhe në Raportin vjetor të Sigurimit të Cilësisë ky komision ka për qëllim monitorimin e programeve akademike, njësive akademike, njësive të mbështetjes akademike dhe qendrave kërkimore dhe instituteve, duke përdorur Politikën dhe Proceset Akademike të Sigurimit të Cilësisë; lehtësimin e procesit të rishikimit për të siguruar ecurinë sipas Politikës dhe Procesit Akademik të Sigurimit të Cilësisë. Kjo përfshin orientimin dhe këshillimin e personelit të rishikimit, dhe monitorimin dhe menaxhimin e përparimit të rishikimeve. Gjithashtu, komisioni merr dhe vlerëson të gjitha dokumentet e prodhuara për proceset e rishikimit, kthimin e dokumenteve kur kërkohet rishikimi dhe miratimin e dokumenteve kur ato janë të plota, shpërndarjen e rezultateve të



rishikimit të sigurimit të cilësisë kur ato të përfundohen dhe miratohen. Ky komision raporton çdo vit për Senatin dhe bordin e drejtorëve për implementimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë bazuar në procese, shqyrtime etj.

Anëtarët e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standardeve të Cilësisë së Institucionit vetëkandidohen dhe zgjidhen prej Senatit Akademik. Anëtarët e komisionit të deklaruar janë relativisht të rinj në pozicionet e tyre brenda këtij komisioni.

Nga të dhënat e DVV konstatohet se UNYT është partner në projektin Erasmus + “QainAL: Mbështetje strategjike për forcimin e strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri” me qëllim krijimin dhe mbështetjen e proceseve dhe mekanizmave për të siguruar menaxhim efektiv dhe përmirësim të mësimdhënies në këto institucione. Kjo i ka shërbyer IAL të përmirësojë praktikën e sigurimit të cilësisë, sikurse u përmend edhe nga takimin me anëtarët e këtij komisioni, gjatë vizitës së institucionit.

Në takim me KoGaSCI, GVJ u informua për procedurat standarde të funksionimit të këtij komisioni. Ajo që u veçua nga kryetarja e komisionit Dr. E.K, ishte mundësia që për vendimet e marra në institucion të dëgjohet zëri i personelit akademik dhe të dërgohet te Rektori dhe se studentët kanë hapësirën për të raportuar problemet që kanë me pedagogët e tyre, krahas vlerësimeve të standardizuara. Po ashtu, KoGaSCI në rastet kur nga përpunimi i të dhënave të pyetësorëve të studentëve, prej koordinatorës së kësaj zyre MSc. R.A, të dhënat ndahen me drejtuesin e departamentit, me tej bëhet një diskutim me pedagogun, parashikohet një seance vlerësimi nga një kolegë dhe jepen udhëzimet për përmirësime. Nëse komentet janë shumë negative, atëherë njoftohet dekanati dhe rektori.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
  - Në çdo vit akademik, studentët kanë mundësi të japin vlerësimin e tyre për procesin e mësimdhënies në secilin semestër. Ato janë me bazë pikësh por edhe verbale. Vlerësimi realizohet nga Asistentja e Rekorit dhe koordinatoresha e SCB.
  - Numri maksimal i studentëve që kanë marrë pjesë në anketime ka qenë 90 dhe minimal 50. Studentët e bëjnë vlerësimin në javën e 3 para provimit final dhe përzgjidhet dita kur janë të pranishëm më shumë sesa gjysma e studentëve në klasë. Sipas Raportit Vjetor të Sigurimit të Cilësisë 2017-2018, të dhëna për këtë program studimi janë dhënë bashkërisht me programet e tjera bachelor, pra pa specifikuar për BSc Psikologji, numri i kurseve të vlerësuara për të dy semestret ka qenë 181 dhe numri total i studentëve që kanë realizuar vlerësimet 1805.
  - Pyetësorët janë përpunuar me metoda sasiore dhe cilësore dhe përfundimet i janë përcjellë edhe drejtuesit të Departamentit të Shkencave Sociale.
  - Rezultatet e vlerësimit i përcillen individualisht secilit prej pedagogëve nga drejtuesi i njësisë bazë.

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i Brendshëm i Cilësisë në IAL UNYT realizohet nga Sistemi i Sigurimit të Cilësisë, i cili përbëhet nga Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Standardeve të Cilësisë së Institucionit.



NjSBC ka si funksion të saj drejtimin, këshillimin dhe mbështetjen për hartimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë në përputhje me ligjin, aktet nënligjore, Statutin dhe Rregulloren e universitetit, Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Standardet për Sigurimin e Cilësisë. Sikurse konstatohet në DVV, UNYT përdor disa metoda për të kontrolluar cilësinë të tilla si anketimin e studentëve për vlerësimin e performancës së pedagogëve dhe lëndës, vetdeklarimi i pedagogëve për performancën e tyre, vlerësimet e kolegëve, etj.

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (Aneksë, Tabela 7)

Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Standardeve të Cilësisë dhe Koordinatori i Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me dekanët e fakulteve, drejtuesit e departamenteve për programet që mbulojnë janë përgjegjësit për çështjet e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies. Drejtuesi i Departamentit në çdo vit akademik duke bashkëpunuar me koordinatorin e programit të studimit merr informacion mbi të dhënat e vetvlerësimit të stafit akademik, ku përfshihet kërkimi shkencor, angazhimi i stafit akademik në institucion, ngarkesën e mësimdhënies dhe në raportin vjetor të departamentit reflekton planet e nevojshme të veprimit në kuadër të përmirësimit të cilësisë.

- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Departamenti i Shkencave Sociale në përfundim të çdo viti akademik realizon një raport vjetor në të cilin përshkruan çështjet e ngritura gjatë vitit akademik dhe planet e veprimit të ndërmarra për çështjet e ngritura një vit më parë. Në këtë raport raport prezantohet objektivat e departamentit, zhvillimi i kurrikulës, caktimi i objektivave për vitin e ardhshëm. Gjithashtu, prezantohen edhe pikët e vlerësimit për të gjithë pedagogët për lëndët që kanë dhënë në secilin semester, si dhe transparenca e notave, një proces ky i realizuar duke përzgjedhur rastësisht disa kurse për të parë përputhshmërinë e vlerësimit me standardet.

- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Sikurse prezantohet në RVB, në dokumentacionin mbështetës dhe në takimin me zyrën e Sigurimit të Cilësisë, UNYT përditëson në mënyra të rregullta periodike procedurat dhe politikat e sigurimit të cilësisë. Rezultatet e marra nga metodat e ndryshme të matjes së performancës akademike në IAL shqyrtohen nga KoGaSCI dhe Senati, në rastet kur nevojitet ndërhyrje për ndryshime në politika dhe praktika të miratuara. Partenriteti me projektin Erasmus +: QainAL vlerësohet nga IAL si një mundësi e mirë për përmirësimin e praktikave të sigurimit të cilësisë.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Takimi me Drejtuesin e Departamentit
- Takim me stafin e angazhuar në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë, UNYT 2018
- Shqyrtimi i Manualit të Sigurimit të Cilësisë UNYT
- Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Sociale
- Formulari i Vlerësimit të Studentit
- Formulari i Vlerësimit të Performancës Vjetore Individuale
- Forma e Vlerësimit të Mësimdhënies nga kolegët
- Sistemi për Vlerësimin e Kërkimit Shkencor
- Forma e promovimit akademik nga Dekani



- Raporti i Sigurimit të Cilësisë në Transparencën e Notave – Departamenti i Shkencave Sociale
- Plani Strategjik UNYT 2018-2022, “Qëllimi strategjik, numër 5”
- Udhëzuesi i Pedagogut (Instructor's Handbook)

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Vlerësimi me nota/pikë;</li> <li>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li> <li>Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UNYT përdor një sërë metodash për të matur dhe vlerësuar ecurinë e programit të studimit. Kjo bëhet në mënyrë periodike, në fund të çdo semestri. Informacioni i marrë nga NjSBC, pas analizës, i kalohet Senatit dhe nga aty merren vendime për ecurinë e mëtejshme lidhur me garantimin e parametrave të cilësisë. Në RVB cilësohet se ky raport ndahet me aktorët, pa treguar nëse aktorët përfshihen edhe palë të tjerë jashtë IAL, siç mund të jetë publiki i gjerë, përmes publikimit të tij në faqen zyrtare të IAL.</p> <p>Sikurse përshkruhet në RVB dhe konstatohet nga dokumentacioni i shqyrtuar, NjSBC për të kryer vlerësimin ka në dispozicion disa instrumente të për të realizuar matjen e cilësisë së mësimdhënies dhe ecurisë së procesit të edukimit. Këto instrumente dhe procedura përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimin e studentit</li> <li>- Transparenca e notës</li> <li>- Formulari i vlerësimit të performancës individuale</li> <li>- Raporti Vjetor i departamentit</li> <li>- Rezultatet e kërkimit shkencor</li> <li>- Raporti i monitorimit të programit</li> <li>- Objektivat dhe monitorimi vjetor në nivel departamenti – plan veprimet e realizuara</li> <li>- Mjete të tjera (raportet e monitorimit të shërbimeve të studentëve- zyra e regjistrimit, zyra e karrierës, qeveria studentore, etj)</li> </ul>
<b>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</b>	
<b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p>	<p>IAL UNYT është vlerësuar nga ekspertët e ASCAL, në bashkëpunim me ekspertët e QAA, dhe me vendim të Bordit të Akreditimit, nr. 102, datë 10.11.2017, ka marrë riakreditimin institucional me kohëzgjatje 3 vjeçare (2017-2020).</p>



**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

UNYT ka struktura të posaçme dhe instrumentë për të matur cilësinë dhe për të hartuar politikat e duhura për përmirësimin e mëtejshëm.

Manuali i Sigurimit të Cilësisë është instrumenti insitucional që përdoret nga KoGaSCI. Vërtetohet nga takimi me komisionin e sigurimit të cilësisë se vlerësimet e studentëve, vlerësimet e pedagogëve për kolegët e tyre, vetvlerësimet e performancës akademike, janë instrumente që IAL përdor për të kontrolluar dhe përmirësuar cilësinë e vet, duke përfshirë të gjithë aktorët për të kontribuar në këtë proces.

Gjithashtu vërtetohet se IAL ka hartuar strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, por këto janë të aksesueshme vetëm për personelin brenda IAL dhe nuk janë të publikuara në faqen zyrtare të IAL.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se IAL disponon procedurat, standardet dhe instrumentet e nevojshme për të vlerësuar dhe garantuar cilësinë e ofrimit të këtij programi studimi. Vlen të theksohet se IAL si pjesë e partneritetit me Erasmus + në projektin QainAL ka mundësi të përditësojë dhe të përmirësojë metodologjitë e sigurimit të cilësisë. Po ashtu, vlen të theksohet se vlerësimi i pedagogëve për kolegët e tyre gjykohet si një metodë e vlefshme për të përmirësuar syllabuset e lëndëve dhe procesin e mësimdhënies.

*Sugjerohet që institucioni të publikojë në faqen zyrtare të internetit raportet vjetore të sigurimit të cilësisë, masë kjo që do të shtonte edhe më shumë besueshmërinë dhe transparencën e institucionit te opinioni publik.*

## **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Sipas bisedimeve me Dekanin e institucionit, Përgjegjës in e departamentit dhe me stafin akademik efektiv e studentët, si dhe sipas RVB vërtetohet se studimet e ciklit të parë BSc në Psikologji në UNYT i ofrohen studentëve me kohë të plotë dhe në gjuhën angleze, studentëve që vijnë nga matura shtetërore zotërojnë gjuhën angleze në nivelin B2. Kohëzgjatja (normale) e programit shtrihet në katër vite akademike me 256 ECTS. Me përfundimin e studimeve të ciklit të parë Bachelor në Psikologji, institucioni lëshon diplomë "Bachelor në Psikologji", të shoqëruar me suplementin e diplomës.

Lëndët e kurrikulës përfshijnë lëndë bazë dhe lëndë të specialitetit. Në këtë kurrikul parashikohen disa lëndë të disiplinave të formimit të përgjithshëm me rreth 42 kredite ECTS, ku në këto lëndë



përfshihen Compositions I dhe II, College Algebra, Art Course, US History, etj., përshihen lëndë të disiplinave të formimit karakterizues me 114 kredite ECTS me lëndë si Histori e Psikologjisë, Psikologji e përgjithshme, Psikologji klinike, Psikologji kognitive, Psikologji sociale, Psikologji Anormale, Teori të këshillimit, Psikologji edukimi, etj., përshihen lëndë të disiplinave të ngjashme ose integruese me rreth 42 kredite ECTS si Biologji humane, Biologjia e përgjithshme, Statistika, Sjellja organizacionale, etj., lëndë me zgjedhje me rreth 24 kredite ECTS, njohuri të tjera formuese në gjuhë të huaja, informatikë e praktika me rreth 34 kredite ECTS dhe teza e diplomës me 8 kredite. Në total përftohen 256 kredite. *Grupi i vlerësimit të jashtëm, mban në konsiderat faktin e detyrimeve që IAL ka ndaj partneritetit të tij me SUNY (sikurse u prezantua nga takimi me grupin e vlerësimit të brendshëm) për kurrikulën që mundëson marrjen e diplomës së dyfishtë dhe sugjeron që në hapësirën që lejohet të rishikohet kurrikula për lëndët e disiplinave të formimit të përgjithshëm dhe atyre integruese, për të shmangur mbivendosje të tematikave të trajtuara në sylabuse. Për shembull, rasti i lëndës "Biologji Humane" dhe "Biologjia Sot" ku nga shqyrtimi i sylabuseve ka disa çështje që janë të ngjashme dhe mund të konsiderohet shkrirja e saj në lëndë.*

Vitet akademike përmbajnë disa lëndë me kreditet përkatëse: kështu viti i parë përmban 60 kredite dhe ka 10 lëndë; viti i dytë ka po 60 kredite dhe zhvillon 10 lëndë; viti i tretë po 60 kredite e ka 10 lëndë; dhe viti i katërt ka 76 kredite dhe ka 10 lëndë. Në vitin e parë dhe të dytë studentët marrin lëndë të cilët janë bazike dhe të përgjithshme dhe në vitin e tretë e të katërt lëndët janë më të fokusuara në Psikologji e fushat e saj të studimit. Viti i parë e i dytë nuk përmban në kurrikulën e tij lëndë me zgjedhje, ato janë në vitin e tretë dhe të katërt.

BSc Psikologji është një program i cili synon t'i pajisë studentët me njohuri bazike në këtë fushë si dhe t'i aftësojë ata me aftësi analitike e kritike në fushat psikologjike. Fushat e specialitetit që mbulohen nga ky program përfshijnë psikologjinë e zhvillimit të njeriut, psikologjinë sociale, atë kognitive, problematikat e shëndetit mendor dhe trajtimin e tyre, psikologjinë e punës, psikologjinë e edukimit si dhe metodat e kërkimit në shkencat e aplikuara. Patjetër që një bazë e tillë e përgatit studentin për zgjedhjen e specialitetit të masterit që ai dëshiron të vazhdojë më pas nga fushat e këshillimit e klinikës, deri në fushat e shërbimeve publike apo edukimit e arsimit, burimet njerëzore apo kërkimore në psikologji. *Do të ishte e këshillueshme që IAL dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale të krijojë mundësinë që studentët e diplomuar nga ky program studimi dhe jo vetëm të kenë mundësi që të zgjedhin një specialitet të masterit brenda UNYT. Studimi i tregut që UNYT sugjerohet që të ndërmarë të eksplorojë gjithashtu edhe kërkesat për specialitetin e masterit më të kërkuar nga tregu i punës.*

Nga dokumenti i rregullores së programit Bsc në Psikologji mësohet se ky program synon të arrijë suksesshëm disa objektiva:

- Përgatitjen e psikologëve me njohuri bazë në aspektet sociale, emocionale, zhvillimore dhe të patologjisë së sjelljes njerëzore;
- Përgatitjen e psikologëve për të qenë profesionistë të aftë në komunikim e bashkëpunim si dhe të vazhdojnë rritjen e tyre të mëtejshme akademike;
- Përgatitjen e profesionistëve drejt fushave të kërkimit shkencor në psikologji.

Në përfundimin e programit të studimit, studenti duhet të jetë në gjendje të: tregojë njohuri për të kuptuar dhe shpjeguar sjelljen, mendimet dhe ndjenjat njerëzore; tregojnë njohuri për dukuritë e ndryshme psikologjike; zotërojnë njohuri mbi teoritë e ndryshme psikologjike që studiojnë personalitetin njerëzor duke theksuar avantazhet e disavantazhet e teorive; shfaqë njohuri për



ndryshmet fizike, emocionale e mendore të individit gjatë zhvillimit të tij; zhvillojë njohuri mbi parimet e të nxënit, kujtesës e të menduarit për zgjidhjen e problemeve; tregojnë njohuri për studimet psikologjike si dhe të vlerësojnë këto studime; dallojnë çrregullimet psikologjike e njohin trajtimin e tyre; si dhe të njohin rolin që luan trashëgimia dhe mjedisi në ndryshimet e qënies njerëzore gjatë zhvillimit jetësor.

Lidhur me aftësitë e përfuara të studentit që përmbush detyrimet e këtij Bsc mund të thuhet se ai fiton: kuptim mbi sjelljen njerëzore e proceset e të menduarit, aftësi kritike mbi probleme që lidhen me sjelljen, aftësi shkrimi në detyra të ndryshme, komunikim me zotësi edhe përmes teknologjisë, aftësi pune në grup, aftësi për të manipuluar të dhënat sasiore përmes përpunimit e interpretimit të tyre, zotërim të gjuhës së huaj angleze.

Nga viti i fundit i akreditimit, 2013 deri në vitin aktual akademik 2018-2019 janë bërë disa ndryshime në kurrikulën. Rreth 4 lëndë janë zëvendësuar me lëndë të reja dhe një lëndë e re është shtuar me një total prej 38 ECTS. Ndryshimet përbëjnë rreth 14.8% të gjithë programit. Këto ndryshime kanë ardhur nga këndvështrimet e marra nga pedagogët dhe studentët gjatë eksperiencës disa vjeçare për të përfuar më shumë njohuri dhe plotësuar nevoja të studentëve për kurrikulën përkatëse.

Gjithashtu vlen të përmendet që disa prej lëndëve mund të jenë të ofruara brenda të njëjtit semestër në sesione të ndryshme dhe nga pedagogë të ndryshëm për arsye që të gjithë studentët të zgjedhin orarin më të mirë të mundshëm të përshtatshëm për ta gjatë javës

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi BSc në Psikologji është licensuar përmes dekretit Nr. 518 në gusht të vitit 2003, nga Ministria e Arsimit të Republikës së Shqipërisë dhe operon në mënyrë të vazhduar nga ky vit. Ky program është zhvilluar dhe organizohet e supervizohet edhe nga State University of New York/Empire State College dhe është i ndërtuar sipas sistemit amerikan të arsimit të lartë. Është program me katër vite dhe lëndët në fakt organizohen sipas krediteve amerikane dhe shkallës së vlerësimit amerikan. Ky program ndjek kushtet dhe specifikat e sistemit amerikan të ngarkesës me leksione e seminare ose praktika që janë të ndërthurura dhe jo të ndara. Programi përmban 128 kredite amerikane të konvertuara në 256 ECTS.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- |                     |                                  |
|---------------------|----------------------------------|
| ➤ 1 vit akademik ka | 30 javë mësimore në auditor      |
| ➤ 1 Semestër ka     | 15 javë mësimore në auditor      |
| ➤ 1 ECTS            | 25 orë mësimore punë e studentit |
| ➤ 1 orë mësimore    | 60 minuta                        |

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Shih Anekse, Tabela 8.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 45 orë në auditor dhe 105 orë punë e pavarur e studentit për lëndët me 3 kredite amerikane ose 6 ECTS



- Për leksionet 60 orë në auditor dhe 140 orë punë e pavarur e studentit për lëndët me 4 kredite amerikane ose 8 kredite ECTS
- Për Seminaret orët e seminareve nuk janë të ndara specifikisht nga orët e leksioneve
- Për Labororet nuk zhvillohen orë laborator
- Për Praktikant lëndore nuk ka praktika lëndore të veçanta në lëndë të caktuara
- Për Praktikën Profesionale 140 orë praktikë në vitin e katërt të studimeve
- Provimi përfundimtar 3 orë në auditor java e fundit e semestrit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Shih Anekse, Tabela 8/1.

Planet mësimoretë lidhura me personelin akademik përkatës

Shih Anekse, Tabela 9.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset e lëndëve paraqiten të plota. Kanë një strukturë të ngjashme të gjitha. Në hyrje të çdo syllabusi jepet struktura e lëndës, përshkrimi i përgjithshëm i lëndës, emri i pedagogut që zhvillon lëndën, parakushtet që duhet të plotësohen për të zhvilluar lëndën, çështjet etike në ndjekjen e lëndës, si dhe ndarja e orëve mësimore në auditor dhe jashtë auditorit. Janë të përcaktuara detyrimet e studentit dhe forma e vlerësimit. Gjithashtu në syllabus përfshihen edhe detyrimet e studentit për lëndën, rezultatet e të nxënit, temat e leksioneve dhe orëve praktike nëse do të ketë, literatura bazë dhe ajo ndihmëse si dhe kontakti i pedagogut. Zërat e syllabuseve janë të plota dhe ato të nevojshmet.

Kalendari akademik i UNYT ka dy semestra, i pari i referohet semestrit të vjeshtës dhe i dyti i referohet semestrit të pranverës.

Rregullorja e programeve të BSc në Psikologji në UNYT i jep hapësirë studentëve të të gjitha programeve BSc në këtë institucion që përmes ndihmës dhe këshillimit me këshilluesin akademik që kanë përcaktuar që në fillim të vitit akademik të zgjedhin, ndryshojnë ose riorganizojnë fitimin e krediteve brenda hapësirës që studentët kanë në të mirën e të ardhmes së tyre të studimeve. Kjo i jep studentëve edhe mundësinë e rishikimit të vazhdimësisë së studimeve dhe mos humbjes së



krediteve të fituara deri në atë moment. Kështu, studenti zgjedh lëndët për çdo semestër me këtë proces këshillimi.

Ndarja e orëve në auditor sipas veprimtarive të ndryshme (leksion, seminar apo praktikë e provime) për secilën lëndë, nuk specifikohet që më parë për arsyen se kurrikulat apo rregulloret nuk e udhëzojnë një gjë të tillë dhe kjo ndarje i lihet e lirë pedagogut përkatës. *Gjithësesi sugjerohet që një ndarje të tillë pedagogu duhet ta specifikojë në silabus pavarësisht lirisë së tij për shkak të nevojës së orientimit të studentit dhe jo vetëm.*

Vlen të theksohet edhe fakti se versioni përfundimtar i silabuseve bëhet nga përgjegjësi i departamentit në fillim të vitit akademik i cili vlerëson edhe cilësinë e silabusit si dhe përditësimin e zhvillimeve më të fundit në fushë. Vlerësimi i cilësisë së silabuseve përmbushet edhe përmes procesit të 'peer evaluation' që aplikohet në nivel departamenti ku kolegët mund të vlerësojnë cilësinë e materialeve (edhe të silabuseve) të lëndëve të njëri-tjetrit.

Vlen të theksohet gjithashtu se përgjithësisht i gjithë stafi që lektrojnë në këtë program studimi është i specializuar në fushën përkatëse, por stafi akademik i departamentit për lëndët e veprimtarive në disiplina të formimit karakterizues që përmban edhe numrin më të madh dhe kryesor të krediteve 114 ECTS, është vetëm 3 lektorë me gradën shkencor Dr ose PhD me kohë të plotë. *Sugjerohet shtimi i stafit akademik për të lehtësuar ngarkesën mësimore në auditor dhe mbuluar atë më së miri.*

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Biseda me përgjegjësin e departamentit dhe dekanin;
- Biseda me studentët;
- Biseda me grupin e RVB;
- Biseda me stafin akademik efektiv.

#### **Si dhe dokumentet:**

- CV e personelit akademik që lektrojnë në këtë program studimi;
- Silabuset e lëndëve;
- Rregullore e programeve të Bsc në UNYT;
- Diploma Bachelor në Psikologji;
- Suplementi i diplomës;
- Procedurat për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies;
- Partneriteti me University State of New York Empire State College;
- Evidenca për komunikimin me ESC për kurrikulat mësimore;
- Evidenca për diplomatat e dyfishta;
- Biblioteka e UNYT;
- Dosja e personelit akademik me kohë të plotë e part-time;
- Kontratat e punës së personelit akademik me kohë të plotë e part-time;
- Ngarkesat e pedagogëve lektues në Bsc Psikologji për vitet akademike 2017-2018 dhe 2018-2019.

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
---------------------	--------------------------



**I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA****Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.**

**Kriteri 1** Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);

**Kriteri 2** Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;

Nga të gjitha dokumentet e konsultuara të vëna në dispozicion por edhe nga bisedat me stafin e programit BSc në Psikologji në UNYT vërtetohet se ky program jep 128 kredite amerikane (ekuivalente me 256 ECTS) duke përfshirë lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje.

Kreditet amerikan është i konvertuar me rreth 15 orë në auditor, 20-30 orë punë e udhëhequr ose e pavarur e studentit dhe 5-10 orë punë grupi. Një kredit amerikan është 2 kredite ECTS. Ndarja e orëve të punës së studentit është brenda normave të ligjeve në fuqi.

Në një vit akademik studenti grumbullon 64 kredite ECTS. Dhe në katër vite sasia e krediteve të grumbulluara shkon 256 ECTS.

**II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE****Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.**

**Kriteri 1** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;

**Kriteri 3** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

**Kriteri 4** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për sylabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

Pas bisedave me stafin akademik që lektrojnë në program si dhe me përgjegjësin e departamentit vërtetohet se në çdo fillim viti akademik, departamenti projektton lëndët për semestër dhe sylabuset e lëndëve vlerësohen. Planet e lëndëve mësimore miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe nga dekan. *Do të ishte e sugjerueshme që të specifikohet që në sylabus një ndarje e orëve të lektimit dhe atyre të seminareve, pavarësisht lirisë së pedagogut për të organizuar lëndë, kjo do të sillte orientim të studentit dhe jo vetëm lëndët e detyruara dhe ato me zgjedhje i qartësohen studentëve për vitin akademik me ndihmën e këshilluesit akademik.*

Sekretaria mësimore evidenton ngarkesën mësimore të pedagogut si dhe orët faktike të realizuara në auditor. *Sugjerohet shtimi i stafit akademik për të lehtësuar ngarkesën mësimore në auditor dhe mbuluar atë më së miri.*

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Programi i studimit plotëson kriteret ligjore në lidhje me politikën e formimit të studentëve.

Përmbajtja dhe organizimi i programit të studimit përgjithësisht është i ndërtuar në mënyrë të përshtatshme dhe brenda kriteve për arritjen e qëllimit të tij.

Sasia e krediteve për vitin akademik është 64 kredite ECTS dhe në total pas katër vitesh studimi studenti fiton 256 ECTS.

Informacioni i nevojshëm i vihet në dispozicion studentëve nga njësitë kryesore në fakultet, zyra e regjistrimit të tyre. Ndërkohë pranë studentëve qëndron gjithnjë një këshillues akademik për udhëzimet në ndjekjen e lëndëve të detyrueshme dhe atyre me zgjedhje për t'i ndihmuar ata të përputhin kurrikulën me interesat e tyre. Studentët njihen me sylabuset e lëndëve edhe nga pedagogët përkatës si dhe politikën e frekuentimit të lëndës.

*Dëshmojmë se grupi i studentëve që pret të diplomohet janë një numër relativisht i vogël që sugjerohet të shtohen më shumë në vitet në vijim. Në këtë kuadër hapja e një programi studimi master në fushën e psikologjisë mund të shihet me interes për studentët e diplomuar në BSc Psikologji për të patur vijimësi në studimet e tyre dhe për të dalë të kompletuar në tregun e punës.*



## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia është një element i rëndësishëm i procesit mësimor në këtë program studimi. I gjithë programi synohet të përmbushet përmes metodologjive të spikatura të mësimdhënies. Institucioni është promovues i majft formave të ndryshme të mësimdhënies. Kjo u diskutua me disa grupe interesi si me studentët, pedagogët lektues në program ashtu edhe me përgjegjësin e departamentit dhe dekanin e fakultetit. Aplikohen forma në varësi të disiplinës si dhe në varësi të objektit dhe qëllimit të temës: *leksioni, orë praktike, detyrat individuale, bashkëbisedimi, debati, situata rasti, kërkimi individual*. Procesi i mësimdhënjes përmbushet duke kombinuar metoda klasike si leksioni, me metoda që stimulojnë arsyetimin, argumentin, kontekstin socio-kulturor të sjelljes si dhe metodologji që nxisin të menduarit kritik. “Rasti studimor”, si metodologji, përdorej mjaftueshëm, por gjithashtu edhe “debati” e “dialogu” ku pikëpëriten arsyetimet, ishin metoda të përdorura nga stafi. Kjo e stimulon metodologjinë interaktive krahasuar me atë të parashtrimt të pastër teorik. Kontrolli i dijeve që marrin studentët përmbushet përmes tezave, mendimit hipotetik, arsyetimit intuitiv dhe të strukturuar.

Gjatë procesit mësimor zhvillohen: leksione, studime rasti, kërkime, detyra kursi, provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, praktika profesionale dhe së fundmi edhe punim i diplome që është empirik.

Gjithashtu edhe praktika profesionale është një veprimtari formuese, e cila ndikon drejtpërdrejt në aftësitë praktike të studentit. Këto praktika organizohen dhe zhvillohen në institucione publike dhe private, me të cilat UNYT ka marrëveshje bashkëpunimi [Dokumenti-Politikat e bashkëpunimit dhe marrëveshjet e partneritetit].

Ndër to mund të përmendim institucione si: Bashkia e Tiranës, Urdhri i Psikologut, spitale, Banka të ndryshme, etj. me të cilët janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi që ndihmojnë për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve para diplomimit të tyre. Këto praktika ndiqen dhe mbikëqyren nga pedagogë të departamentit.

Përfshirja e personelit akademik në këtë proces mësimdhënës është e domosdoshme për të siguruar që studentët të përftojnë maksimalisht të gjitha nevojat e tyre për studim dhe përfshirje.

Nga ana tjetër, vlen të përmendim edhe vlerësimin si proces nga studentët të moduleve të lëndëve, në fundin e tyre studentët marrin pjesë në një proces vlerësimi për efikasitetin e silabusit, nevojat për përshtatje, aplikimin e metodave të përdorura për të nxënësit si dhe aktivizimin krijues e dinamik të tyre në lëndë.

Thuhet në të gjitha lëndët duke parë silabuset e lëndëve dhe nga diskutimet me pedagogët, pra stafin PAE dhe studentët mësohet se në to aplikohen ndarja e pikëve të lëndës në momente të ndryshme të saj nga provimi i mesit të semestrit dhe deri në pjesëmarrjen në auditor, komponenti kërkimor përmes një detyre ose projekte dhe provimi përfundimtar. Pikë e fortë u vu re edhe pajisja



dhe aksesit që pedagogët kishin në softuerin Turnitin.com për të vlerësuar edhe plagjaturat e mundshme të studentëve.

Duke parë silabuset dhe plan programet e lëndëve thuajse të gjitha kanë rreth 3-4 orë mësimi në javë dhe kjo i vihet të dispozicion që në fillim të semestrit studentit me orarin dhe lëndët përkatëse. Orari është i adaptueshëm për të gjithë studentët dhe institucioni është i hapur nga ora 8:00-21:00. Në rregulloren e programit mësohet se ndjekja e lëndëve është e detyrueshme në masën 80% . Ankesi 3 Rregullore e programeve Bachelor.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet, Aneks Tabela 10.

Llojet e format e mësimdhënies janë të përmbledhura kryesisht për të gjitha lëndët në dy grupe leksione dhe laborator dhe lëndët kryesisht kanë ngarkesën prej 3 kreditesh si dhe me një total prej 45 orësh në auditor dhe për lëndët me 4 kredite në një total prej 60 orësh në auditor. Kreditet janë kredite amerikane dhe të përkthyer në sistemin tonë arsimor i përkasin 6 dhe 8 krediteve ECTS. Lënda në auditor ka kryesisht numrin e diskutuar më sipër dhe i lihet në dorë pedagogut për të vlerësuar nëse do të ndajë orët leksion nga ato seminar/laborator dhe totali do të mbetet i njëjtë. Rëndësia e orëve leksion ose seminar është e njëjtë. Studenti njihet me këtë ndarje në fillim të lëndës me anë të silabusit të saj.

Format e kontrollit të njohurive

Sa i përket formave të kontrollit të njohurive përgjithësisht në lëndë janë të përfshira disa pika me përqindjet e tyre si pjesëmarrja në lëndë, plotësimi i detyrimeve laboratorike dhe detyrave të kursit, testimet gjatë lëndës, prezantimet gjatë semestrit dhe provimi përfundimtar me një total prej 100% të pikëve, për më tepër referoju Aneks, Tabela 11. Sistemet e vlerësimit për lëndën janë të specifikuar në çdo silabus lënde dhe gjithashtu të vërejtshme në Aneksin 2.2 të dokumentacionit të dorëzuar. *Gjithësesi, sugjerohet që në rregullore dhe silabuset e lëndëve të parashikohet një ndarje e orëve laboratorike/seminare me qëllim që ketë orientim dhe organizim të lëndës si për studentët edhe pedagogun e lëndës të ndajë dhe si do të organizohet në lëndë. Kjo ndihmon për strukturim dhe orientim të dyanshëm. Gjithashtu një qartësim i tillë do të ishte me vlerë edhe për pritshmëritë e studentëve si dhe matjen e aftësive konkrete të tyre në kërkesat e lëndës përkatëse.*

Shkalla e vlerësimit që aplikohet për këtë program 4 vjeçar i korrespondon modelit amerikan dhe notat specifikohen me shkronjat A-F duke i korresponduar notave në përqindje. Përkthimi i notave dhe përqindjeve varion nga puna e dalluar në punë që nuk plotëson standardet e kriteret e kërkuara. (Shiko Aneks Tabela 18). Kjo është e verifikueshme nga silabuset dhe nga Aneksi 3 i dokumentacionit të vënë në dispozicion seksioni 7.5 – Sistemi i vlerësimit të UNYT.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj (Aneks, Tabela 13)

Aktivizimi i studentëve të programit është bërë përgjithësisht në këto zëra: punime shkencore individuale (25 të tilla); projekte shkencore në rang Departamenti (78 të tilla); projekte shkencore në rang fakulteti (78 të tilla); si dhe projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë (një).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Për këtë pikë dokumentacioni i marrë në institucion përfshin:



1. Takimi me përgjegjës të departamentit, dekanin e Fakultetit,
2. Takimi me stafin PAE,
3. Takimi me studentët.

#### **Si dhe dokumenteve:**

1. Rregullore e Programeve Bachelor,
2. Evidenca të përfshirjes së studentëve të programit BSc në Psikologji,
3. Evidenca për pjesëmarrje në konferenca për programin BSc Psikologji në UNYT.

#### **9. Studentët**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Nga raporti i vlerësimit të brendshëm, takimet me sekretarinë mësimore dhe përgjegjës të departamentit të shkencave sociale mësohet se pranimi i studentëve mbështet në legjislacionin në fuqi dhe në aktet rregullatore të institucionit. Përzgjedhja e studentëve bëhet sipas një rregulloreje të brendshme që institucioni e ka hartuar në bazë të legjislacionit dhe rregullave të vetë institucionit. Numri i studentëve përcaktohet nga kërkesat dhe kapacitetet e stafit akademik dhe infrastrukturës së institucionit. Kohëzgjatja mesatare e zgjatjes së studimeve është 8 semestra.

Gjithashtu, kuotat e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes së studentëve në të gjitha programet e studimit miratohen nga Senati Akademik i institucionit në zbatim të Statutit dhe Rregullores së UNYT. Përcaktimi i kuotave të pranimit, për çdo program studimi, bëhet në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore që disponon institucioni.

Ndër vite vihet re një numër i pakët i studentëve të regjistruar, edhe pse ky numër është rritur disi, rritja është e vogël relativisht.

##### **Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

- Procedurat e pranimit të studentëve

Nëse do t'i referoheshim procedurave të pranimit të studentëve UNYT ka një zyrë që quhet Zyra e pranimit e cila merret me të gjitha procedurat e nevojshme për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj. Politikat e pranimit të studentëve janë të qartësuara në dokumentin Politikat e pranimit të studentëve. Këto procedura janë si më poshtë:

- Para-aplikimet janë të mundura në çdo kohë të vitit kalendarik e akademik;
- Aplikantët marrin informacion përmes Web-it, emailit dhe telefonit ose vizitave në institucion;
- Zyra e pranimeve bën kontrollin e kualifikimit të aplikantit duke verifikuar kriteret e pranimit të përcaktuara me vendimin e Rektoratit;
- Zyra e pranimeve njofton aplikantin për regjistrim nëse është pranuar;



- Nëse aplikanti nuk posedon një rezultat të suksesshëm në asnjë prej Certifikatave të gjuhës angleze, ai i nënshtrohet testit Aptis, që organizohet në bashkëpunim nga zyra e pranimeve dhe BC (British Council);
- Zyra e pranimeve dërgon dosjen e kompletuar në komisionin e pranimit për miratim dhe pastaj dosja dorëzohet në sekretari për regjistrim;
- Nëse kandidati nuk ka rezultat të mirë në testin e gjuhës angleze, ai i drejtohet për regjistrim në lëndën English as a Second language (ESL).

Në këtë institucion ka disa dokumente që aplikanti dhe student duhet të dorëzojnë si më poshtë:

- Formulari i aplikimit
- Fotokopja e noterizuar e diplomës së maturës shtetërore bashkë me certifikatën e notave;
- 4 fotografi;
- Deklaratën e udhëzimit përkatës të vitit akademik aktual;
- Njohjen e gjuhës angleze në nivelin B1 të certifikuar;
- Nota mesatare të jetë minimalisht 6.5.

Gjithësesi nota mesatare përcaktohet edhe nga Vendimi i Këshillit të Ministrave sipas vitit akademik përkatës. Nota mesatare tani është mbi 7.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Numri total i studentëve të regjistruar nga viti 2013 dhe deri në vitin 2018 si të regjistruar për herë të parë është rreth 39 studentë për degën Psikologji dhe të diplomuar deri tani janë rreth 13 studentë. Përgjithësisht studentët në hyrje kanë pasur një mesatare prej 8.1, ndërkohë që në dalje është mesatarisht 3.35 sipas krediteve amerikane.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Shiko në Anekse, Tabelën 12.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Në vitin 2018, u diplomuan 3 studentë me notë mesatare 3.5, sipas sistemit amerikan.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Ky mobilitet nuk aplikohet.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Numri total i të punësuarve është 4 nga 13 të diplomuar gjithsej, ku nga këta 4, dy janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe dy të tjerët jashtë profilit, pjesa e mbetur e të diplomuarve vazhdon studimet master jashtë vendit. (Shiko Aneksat Tabela 19)

Numri total të diplomuarve

Numri total i studentëve të diplomuar nga viti 2013 deri 2018 është 13 studentë.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën është 2 studentë.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)



Numri total i të punësuarve jo në përputhje me diplomën është 2 studentë.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Takimi me Dekanin dhe përgjegjësin e departamentit;
- Takimi me përgjegjësin e zyrës së karrierës dhe marrëdhëniet me të diplomuarit;
- Takimi me grupin e RVB;
- Dokumenti Rregullor e Zyrës së Pranimeve
- Vendimi i senatit akademik për kriteret e pranimit;
- Dokumenti: Statusi akademik dhe ekselenc;
- Politikat e zyrës së karrierës dhe Alumni;
- Manuali i studentit – Student’s Handbook;
- Dokumenti: Kushtetuta e Unionit Studentor;
- Rregullor e brendshme për veprimtarin e sekretarisë mësimore;
- Dokumenti: Detyrat e këshilluesit akademik;
- Dokumenti: Format i këshillimit të studentit;
- Rekordet e kësillimit akademik nga Gnomon;
- Faqja e internetit [www.unyt.edu.al](http://www.unyt.edu.al)

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Vërtetojmë se nga bisedat me përgjegjësin e departamentit dhe dekanin si dhe shqyrtimin e dokumentacionit të rregullores së Zyrës së Pranimeve dhe Vendimin e Senatit Akademik për kriteret e pranimit, procedurat e pranimit të studentëve në ciklin e parë BSc Psikologji në institucionin e UNYT janë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë. Studenti duhet të ndjek dorëzimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme për të qenë i pranuar pranë UNYT.</p> <p>UNYT gjithashtu ka propozuar edhe kriteret të veçanta për pranimin e studentëve në këtë institucion që i ka të përcaktuara në vendimin e Senatit Akademik të UNYT të tilla si niveli i gjuhës angleze në hyrje të studnetit duhet të jetë mbi nivelin B1 dhe nota mesatare në hyrje të jetë 6.5. Për programin e këtij Bachelori në Psikologji nga ky vit akademik 2018 nota mesatare është mbi 7.</p>
<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit</p>	<p>Nga biseda me anëtarë të RVB dhe përgjegjësin e departamentit, dekanin si dhe përgjegjësin e zyrës së pranimeve mësohet se informimi i studentëve realizohet në forma të ndryshme. Këto forma janë: faqja online e UNYT është e pajisur me të dhëna informuese për programin e studimit dhe organizimin e lëndëve, pajisja e studentëve të rinj me manualin e studentit në të cilin informohen ato</p>



<p>të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>rreth UNYT dhe rreth programit të studimit që interesohen të ndjekin, organizimi i Ditës së Orientimit për t'i njohur studentët e interesuar me të dhëna të rëndësishme mbi UNYT dhe programet e studimit që ai ofron, etj.</p> <p>Vërtetojmë se studentët e programit vlerësojnë pedagogun përkatës në lëndët që ata lektrojnë përmes pyetësorëve të vlerësimit dhe kjo ndodh përpara provimit të lëndës.</p> <p>Është për t'u vlersuar fakti që studentët zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Unionin studentor për të patur përfaqësues në Senatin Akadmiq dhe kjo i shërben për të paraqitur edhe ankesat apo problematikat e tyre lidhur me çështje të ndryshme të procesit akademik. Kjo është e qartë edhe në dokumentin e Kushtetutës së Unionit studentor.</p> <p>Zyra e Karrirës dhe Alumni janë funksionale dhe i ofrojnë këshillim të vazhdueshëm studentëve përmundësitë e ardhme të punësimit dhe internshipeve.</p>
<p><b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>UNYT ka të dhëna për numrin e të diplomuarve pavarësisht se në këtë program numri i të diplomuarve është relativisht i vogël. Sekretaria mësimore ka të dhëna për regjistrimet, transferimet, largimet nga programi, diplomimet, dhe ecurinë akademike të të regjistruarve.</p> <p>Sekretaria mësimore regjistron në databazën kryesore të gjitha rekordet e nevojshme për këtë gjë. Gjithë ecuria e procedurave të sekretarisë mësimore paraqitet në rregulloren e brendshme për veprimtarinë e sekretarisë mësimore.</p> <p>Ndër vite vihet re një numër i pakët i studentëve të regjistruar, edhe pse ky numër është rritur disi, rritja është e vogël relativisht.</p> <p><i>Sugjerohet shtimi i numrit të studentëve.</i></p>
<p><b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e karrierës dhe Alumni i ofron studentëve asistencë për zhvillimin e aftësive të tyre në kërkimin e punës, si të shkruajnë një CV, si të ruajnë vendin e punës, si të avancojnë në karrierë, etj.</p> <p>Me vlerë është edhe qendra e Këshillimit të studentëve që ofron edhe këshillim psikologjik për problematika të të nxëniet dhe vështirësive akademike ose edhe qendra e të Shkruarit që i ofron ndihmë të specializuar në shkrimin akademik studentëve. Pra, studentët ndihen të suportuar dhe të ndihmuar në raste të nevojave të ndryshme që mund të kenë përgjatë vitit akademik. Duke qenë se numri i studentëve të</p>



psikologjisë është relativisht i ulët, edhe mbështetja e tyre është e mbuluar nga stafi akademik i departamentit dhe çdo student ka një këshillues akademik përgjatë programit të ndjekur, i cili e këshillon atë lidhur me lëndët me zgjedhje që ai duhet të marrë, kreditet e fituara, nevojat e tij si të përmbushen më mirë dhe këtë e bën përmes takimeve periodike dhe jo vetëm por edhe atyre të paparashikuara. Të gjitha takimet dokumentohen në sistemin Gnomon.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Forma dhe organizimi i mësimdhënies është e përshtatshme për këtë program studimi dhe në përputhje me qëllimin dhe objektivat e tij.

Zyra e këshillimit funksionon në mënyrë aktive dhe ofron këshillime dhe mbështetje për studentët.

Informimi i studentëve lidhur me programin e studimit, procesin mësimor, shërbimeve që u ofrohen apo çdo informacion tjetër, bëhet e mundur nga njësitë përgjegjëse me karakter ndihmës akademik, si dhe nga stafi akademik i departamentit. Këtë informacion institucioni e mundëson nëpërmjet faqes zyrtare, e cila është aktive dhe përditësohet vazhdimisht, Manualit të studentit, Ditës së Orientimit, etj. Zyra e Këshillimit dhe karrierës dhe Alumni funksionon në mbështetje të studentëve dhe i orienton ata në zbulimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës.

Vlen të theksohet fakti që çdo student ka një këshillues akademik që e mbështet dhe udhëheq atë përgjatë gjithë vijimësisë akademike që studenti do të vazhdojë në UNYT.

Institucioni UNYT disponon regjistrin themeltar, të notave dhe të diplomave të studentëve në format hardcopy dhe elektronikë, të cilët plotësohen, ruhen dhe arkivohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Institucioni UNYT mbështet në vijimësi pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale, duke i dhënë mundësinë që të jenë ata vetë pjesë e vendimmarrjes për çështje që lidhen me jetën e tyre akademike dhe sociale, nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në strukturat drejtuese të universitetit.

Ndër vite vihet re një numër i pakët i studentëve të regjistruar, edhe pse ky numër është rritur disi, rritja është e vogël relativisht. *Sugjerohet shtimi i numrit të studentëve në këtë program studimi Bsc në Psikologji.*

### **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

#### **10. Kërkimi shkencor**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Politikat e kërkimit shkencor në programin “Bachelor në Psikologji” priren më së shumti drejt dijes teorike dhe asaj të aplikuar dhe dijes së përthyer në praktikat profesionale dhe didaktike, duke iu referuar qëllimit dhe kohështirjes së programit. Botimet e konfirmuara dhe ato online në këtë cikël shkollimi janë dhe materialet bazë ku studentët hulumtojnë. Nuk konstatohen kërkime të qëllimta në funksion të këtij program, sesa “përtypje” e leksioneve të përgatitura nga stafi në respekt të disiplinave që ata zhvillojnë në auditor. Departamenti nuk ka organizuar konferenca brenda universitetit me fokus psikologjinë, por stimulon pjesëmarrje të stafit në veprimtari kombëtare dhe lokale si dhe ndërkombëtare. Nuk ka revista shkencore të publikuara enkas për psikologjinë por ka përpjekje të mira për ta sjellë në jetë këtë gjë. Ekzistojnë botime si revista me bord editorial në rang institucioni por fusha e tyre nuk lidhet me shkencat psikologjike, më tepër me shkencat ekonomike dhe ato sociologjike.



Mund të thuhet se stafi akademik është angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në politikat kërkimore në funksion të rritjes akademike dhe profesionale. Personeli akademik ka pjesëmarrje në konferenca dhe kongrese ndërkombëtare të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit.

Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë (strukturë e ngjashme me departamentin) është njësia përgjegjëse që dokumenton çdo veprimtari shkencore të kryer në nivel fakulteti.

Çdo fillim viti akademik, departamentet përcaktojnë fushat specifike të kërkimit, mbi të cilat planifikohen dhe puna shkencore individuale e stafit akademik.

Strategjia e Kërkimit të UNYT 2014-2017 synon të rritë kapacitetin e kërkimit shkencor me qëllim që të kryen kërkime dhe prodhime publikimesh drejt një cilësie të lartë. Të pyetur për kërkimin shkencor dhe nevojshmërinë e publikimeve stafi akademik PAE pohoi se qëllimi kryesor i tyre është mësimdhënia cilësore në këtë program studimi dhe më pas edhe publikimet dhe kërkimi shkencor i vazhduar. Kërkimi shkencor në këtë program studimi bazohet kryesisht në hulumtimin drejt një mësimdhënie cilësore si dhe udhëheqjen e detyrave dhe projekteve të kursit të studentëve.

Mësohet nga vizita se universiteti mbështet përgjithësisht projekte të ndërthurura në disiplinat kryesore të tij ato humane e ekonomike. Pavarësisht se nga RVB thuhet se fushat prioritare të interesave kërkimore të fakultetit mbështesin pesë shtyllat e kërkimit së bashku me 16 projektet tematike kërkimore me kontributin e studentëve dhe stafit akademik, nuk vihet re një lidhje konkrete e tyre me këtë program studimi. Studentët të pyetur, por edhe stafi akademik, pohuan pjesëmarrjen e studentëve në 2 projekte kërkimi ku studentët kanë shërbyer si target grupe/grupe kampioni ose si asistentë databaze/operatorë databaze.

Personeli akademik i programit ka marrë pjesë në aktivitete shkencore si konferenca kombëtare e ndërkombëtare, ka botuar si autor i parë tekste të ndryshme në gjuhë shqipe dhe atë angleze, ka botuar artikuj si autori i parë ose bashkëautor në revista jashtë vendit dhe brenda në vitet 2013-2018, si dhe ka bashkëpunuar edhe me universitete të tjera për konferenca shkencore, p.sh., me UET.

Zyra e Projekteve dhe inovacionit pranë këtij institucioni pohon se ndiqen me vëmendje gjithnjë nevoja për zhvillim të kërkimit shkencor dhe stafi mbështetet. Ka një politikë për mbështetjen e stafit për pjesëmarrje në konferenca jashtë vendit dhe mbulimin e shpenzimeve në varësi të përputhshmërisë së konferencës dhe shtyllat e kërkimit të UNYT.

Institucioni ka marrë pjesë në disa projekte në rang institucional jo në rang programi si: ADRIATI si partner (ndjekja e politikave rajonale), bashkëpunimin me projekte të ERASMUS+, modulet e Jean Monnet, etj. Krijimi i fondacionit të Universitetit të New Youk-ut u realizua me qëllim lehtësimin e ofertave për projekte. Janë bërë përpjekje për fitimin e projekteve europiane dhe disa kanë qenë efektive (modulet Jean Monnet). Janë gjithsej shtatë projekte të fituara nga UNYT.

Institucioni gjithashtu ka organizuar 2 konferenca ndërkombëtare jo me fokus psikologjinë në nëntor të vitit 2015: Tranzicioni në Retrospektivë: 25 vite nga rënia e komunizmit, dhe Emigracioni i Punës dhe Shtetësia Industriale.

Në vitin 2016 ka bashkëpunuar në një konferencë në Shkup dhe në maj 2016 UNYT ka organizuar 'Konferencën e Parë Kombëtare Studentore'.



Në vitin 2018 UNYT organizoi konferencën ndërkombëtare përmes grantit Jean Monnet mbi Demokratizimin dhe Pajtimin Etnik. Institucioni organizon edhe leksione të hapura herë pas here si dhe seminare Brownbag (mbrojtjen e temave master dhe të doktoraturës në nivel departamenti), por në programin Bachelor në Psikologji nuk ka vazhdimësi të ciklit të dytë të studimit.

Gjithashtu institucioni motivon edhe stafin akademik në takime të ndryshme ceremoniale për arritjet akademike dhe shkencore për çmimet e Honoris Causa, etj.

Vlen të theksohet se UNYT ka si synim promovimin, zhvillimin e mbështetjen e kërkimit shkencor jo vetëm në dokumentet politike por edhe në nivel praktik. Kjo vihet re edhe nga: integrimi i studentëve të rinj në grupet kërkimore shkencore, në kontaktet që kanë me institucione të tjera publike e private, nga konferencat e organizuara në bashkëpunime dhe botime shkencore si revista të ndryshme shkencore.

*Sugjerohet organizimi i konferencave në fushën e psikologjisë si dhe rritje e bashkëpunimeve për organizime konferencash me këtë fokus edhe me institucione të tjera homologe në vend ose të huaja për transferimin e dijeve dhe gjetjeve kërkimore në fushën e shkencave sociale.*

*Sugjerohet prodhimi i një periodiku botimi si revistë shkencore, në të cilën të evidentohen produktet shkencore institucionale në fushën e psikologjisë dhe jo vetëm.*

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna për kërkimin shkencor

Shih Anekset, Tabelën 14.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga institucioni u morën këto të dhëna dhe u shqyrtuan këto dokumente:

- Takimi me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit;
- Takimi me stafin PAE;
- Takimi me studentët ;
- Takimi me zyrën e Projekteve dhe Inovacionit;
- Strategjia e kërkimit shkencor UNYT;
- Shtyllat e kërkimit 2013-2018;
- Shtyllat e kërkimit 2018-2022;
- Sistemi për vlerësimin e kërkimit shkencor –fakulteti i drejtësisë dhe shkencave sociale;
- Lista e projekteve dhe partnerëve;
- Projektet e financuara nga jashtë ;
- Lista e Brown Bag Meetings;
- Çmimet Doctor Honoris Causa;
- Prodhimtaria kërkimore 2012-2018;
- Evidenca për përfshirjen e studentëve të programit të studimit në konferenca;
- Evidenca për pjesëmarrje të stafit në konferenca;
- Publikimet dhe aktivitetet shkencore të programit të studimit;
- Plan buxhet për kërkime shkencore Bsc Psikologji 2016-2017-2018.



## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga bisedat me Dekanin dhe Përgjegjës të departamentit vihet re se UNYT ka si objektiv po ashtu edhe bashkëpunimin me institucionet homologe dhe krijimin e partneriteteve brenda dhe jashtë vendit. Për këtë qëllim, ky institucion ka ngritur edhe Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, kurse në lidhjet me komunitetin e biznesit është Zyra e Karrierës dhe Alumni që bën lidhjet. Studentët janë përfshirë dhe kanë pasur akses në aktivitete e shërime, si dhe mundësi përmes kësaj zyre për të zhvilluar të ardhmen e tyre. Nga dokumentacioni dhe nga bisedat me kryetarin e zyrës së zhvillimit të karrierës dhe Alumni të mësohet se institucioni ka hartuar programe bashkëpunimi afatshkurtër dhe afatmesëm me universitete, institucione të ndryshme, kompani prodhuese dhe organizata vendase e të huaja.

Institucioni i UNYT ka marrëdhënie bashkëpunimi me IAL-të në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe me institucione të tjera vendase apo të huaja [dokumentet-Lista e marrëveshjeve dhe memorandumeve të bashkëpunimit].

UNYT bashkëpunon me institucione të arsimit të lartë në nivel ndërkombëtar në kuadër të programeve Jean Monnet, Erasmus+ si dhe me institucione të tjera, në kuadër të programeve mbështetëse për kërkimin nga donatorë ndërkombëtarë dhe lokalë. GVJ ju komunikua se institucioni ka ftuar në vijimësi lektorë dhe personalitete të huaja, të cilët kanë sjellë eksperiencën në mjediset akademike (Lista e të ftuarve në programin e psikologjisë).

Zyra e Karrierës dhe Alumni ka lidhje me komunitetin dhe biznesin për prezantime e leksione të hapura si dhe organizon e merr pjesë në panairin e përvitshëm të punësimit 'Career Fair' që ky institucion organizon çdo vit.

Nga ana tjetër edhe Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare themelohet duke pasur parasysh faktin e krijimit, zhvillimit, përcjelljes dhe mbrojtjes së dijeve e përgatitjes së qytetarëve të së ardhmes për të synuar zhvendosjen e burimeve dhe aseteve intelektuale të UNYT.

UNYT ka aplikuar në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në fusha, të cilat janë me interes si për stafin dhe studentët. Fushat ku aplikohet për projekte janë fushat respektive të ofruara nga institucioni si në Shkencat Juridike, Shkencat Sociale dhe Ekonomike, duke marrë parasysh që idetë për projekte gjenerojnë nga stafi akademik të institucionit, të cilët janë eksperte në fushat përkatëse.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Përgjithësisht universiteti UNYT ka realizuar disa marrëveshje me disa partnerë në projekte kombëtare e ndërkombëtare. Gjithashtu, edhe ka realizuar disa leksione e seminare me lektorë të huaj. Numri i pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit rezulton 6.



Gjithashtu, ka një numër të konsiderueshëm për aktivitete shkencore jashtë IAL-së reth 150. Për më tepër referohu Aneksit, Tabelës 15.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

Referohuni Anekse, Tabelës 16.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumentacioni i marrë në institucion përfshin këto të dhëna:

- Biseda me përfaqësuesin e zyrës së Karrierës dhe Alumni dhe Marrëdhënies ndërkombëtare,
- Dokumentin e Politikave të bashkëpunimit dhe marrëveshjes së Partneritetit,
- Dokumenti mbi Politikën e ndërkombëtarizimit,
- Dokumentin mbi Listën e marrëveshjeve,
- Dokumentin mbi Listën e memorandumëve të bashkëpunimit,
- Dokumentin mbi marrëveshjet e bashkëpunimit dhe dokumentin mbi Politikën e Zyrës së Karrierës dhe Alumni.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Verifikohet nga vizita në institucion se ai është inkurajues i promovimit të kërkimeve shkencore përmes zbatimit të disa shtyllave kërkimore në departamente të ndryshme. Për këtë edhe dokumentet si Shtyllat e kërkimit janë të përcaktuara edhe objektivat për fushat e kërkimit. Institucioni ka ngritur disa grupe pune për të çuar përpara disa projekte me interes për fushat e ndryshme të kërkimit në shkencat sociale e humane dhe ekonomike.</p> <p>Nga ana tjetër edhe nga dokumenti i Objektivave vjetore 2016-2017 vihet re angazhimi i këtij institucioni për kërkimin shkencor dhe ecurinë e tij. Nevojitet që ky dokument të përditësohet me plane të reja.</p> <p>Vihet re edhe një ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësive në proceset kërkimore dhe mësimore e në çuarjen përpara të tyre.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë</p>	<p>Verifikohen nga vizita në institucion si dhe nga takimet me dekanin e përgjegjës të departamentit, si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion që UNYT ka arritur</p>



<p>vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>disa marrëveshje bashkëpunimi me një numër institucionesh homologe brenda e jashtë vendit si me qendra kërkimore në vendet e Bashkimit europian, UK, SHBA etj. Verifikohet nga dokumentet e shtyllave të kërkimit, aneksi 22 i dokumentacionit të dërguar.</p> <p>Nga ana tjetër edhe disa pedagogë nga të cilët njëri i departamentit të Shkencave sociale ka përfituar nga mobiliteti i Erasmus +.</p> <p>Institucioni vlerësohet të ketë forcuar mjaft edhe bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm nga biznesi dhe organizata të ndryshme si ato me fokus shërbimesh sociale si psh Shtëpia e kuqe, apo linja e këshillimit për gra e vajza, Observatori i të drejtave të fëmijëve, etj për të rritur mundësitë e ofertave të studentëve për praktika e më vonë vende pune. Edhe vendosja e pikave të bashkëpunimit me Urdhrin e Psikologut shihet me rëndësi për këtë program studimi.</p> <p>Sugjerohet të shtohet numri i bashkëpunimeve me institucione të reja publike e jo publike për përfitimin nga studentët për praktika e vende pune më vonë pas diplomimit.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Institucioni ka realizuar disa marrëveshje bashkëpunimi e memorandume me institucione kombëtare e ndërkombëtare me aktorë të rëndësishëm në vend e jashtë saj.</p> <p>Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Zyra e Karrierës e Alumni synojnë pikërisht rritjen e përpjekjeve dhe pasurisë intelektuale e burimeve për zhvillimin e tyre nga një kontekst lokal në një kontekst ndërkombëtar për arsimin e lartë.</p> <p>Qëllimet e UNYT lidhur me strategjinë 2017-2022 lidhen drejtpërdrejt me ndërkombëtarizimin e këtij institucioni në disa nivele si: ndërkombëtarizimi i studentëve, i stafit dhe krijimi i një rrjeti partneritetesh për kërkimin shkencor si dhe programe shkëmbimi të stafeve studentore, lektore dhe kërkimore.</p> <p>Gjithësesi, për këtë qëllim sugjerohet edhe rritja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione lokale për të siguruar e shtuar organizimin e orëve praktike që mbulojnë programin për t'i dhënë më shumë larmishmëri organizimit të praktikave dhe hartimit të bashkëpunimeve të mëpasshme për mundësi punësimi.</p>	



## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se në lidhje me rekomandimin e parë, për shtimin e numrit të studentëve, IAL ka bërë përpjekje duke përdorur mënyra të ndryshme, por ky numër vazhdon të jetë i ulët, pra ky rekomandim nuk është plotësuar.

Në lidhje me rekomandimin e dytë mbi shtimin e partneriteteve me ushtrues të profesionit të psikologut, universiteti ka rritur numrin e bashkëpunimeve nga akreditimi i fundit, pra, konstatohet se ky rekomandim është përmbushur.

### **II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).**

#### **a. Pika të forta:**

- 1) Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi është i kualifikuar dhe me eksperiencë profesionale në mësimdhënie dhe në fushën e psikologjisë.
- 2) IAL UNYT është në partneritet efektiv me Universitetin Shtetëror të New York (SUNY) dhe lëshon diplomë të dyfishtë me këtë universitet.
- 3) Universiteti New York Tirana ka marrëveshje bashkëpunimi aktive me etnitete që garantojnë cilësi në edukim si Shtëpia Publikuese Ndërkombëtare për tekste mësimore McGraw Hill dhe të tjera si ERASMUS+.
- 4) Universiteti New York Tirana angazhohet në drejtim të ruajtjes së standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare për procesin e mësimdhënies dhe kualifikimit të studentëve, të cilat faktohen në dokumente dhe strategji.
- 5) UNYT disponon të drejtën për të përdorur programin *Turnitin*, si një mënyrë për të nxitur ndershmërinë akademike dhe realizmin e kërkimeve shkencore si nga studentët dhe nga stafi akademik.
- 6) Programi i studimit Bachelor në Psikologji paraqet fleksibilitet për studentët e diplomuar për të konkurruar për specializime të mëtejshme në universitete ndërkombëtare jashtë vendit.

#### **b. Pika të dobëta:**

- 1) Programi i studimit Bachelor në Psikologji ka një numër të kufizuar studentësh.
- 2) Numri i stafit akademik të profilizuar në fushën e psikologjisë është i kufizuar.
- 3) Programi i studimit nuk mbështet në një studim të nevojave të tregut të punës për profilin e psikologut.
- 4) Mungesa e vijimësisë së kualifikimit të studentëve që diplomohen nga ky program studimi në programe të mëtejshme si master profesional apo shkencor.
- 5) Mobiliteti i studentëve në programe të tjera studimi në IAL brenda vendit mbart vështirësi për shkak të strukturës dhe kurrikulës së ofruar.



- 6) Kurrikula e programit të studimit parashikon një numër të konsiderueshëm kreditesh për lëndët e formimit të përgjithshëm dhe nuk ka parashikuar ndarje të orëve të dedikuara leksioneve dhe seminare.

**c. Mundësitë:**

- 1) Mësimdhënia në gjuhën angleze mund të jetë tërheqëse për studentët që vijnë nga vende të ndryshme të rajonit dhe më gjerë.
- 2) Universiteti zotëron marrëveshje bashkëpunimi të rëndësishme siç është ajo me McGrawHill, duke mundësuar plotësimin me literaturë studimi të kohëve të fundit përmes kopjeve fizike të librave.
- 3) Universiteti i New York Tirana ka mundësi të ofrojë programe studimi master, për të siguruar vijimësi të studimeve për studentët e diplomuar nga ky program.
- 4) Shtimi i marrëveshjeve të bashkëpunimi me institucione që ofrojnë shërbime psikologjike do të mundësonte që studentët të ishin më të ekspozuar ndaj kërkesave të tregut të punës dhe të orientoheshin më mirë në profilizime të mëtejshme.
- 5) Partneriteti me SUNY ofron mundësi të mira për të riorganizuar kurrikulën dhe kreditet e lëndëve të specialitetit të psikologjisë, sa më efektivisht brenda normës së lejuar (20% çdo vit akademik).

**d. Pengesat:**

- 1) Konkurrencë e lartë në sektorin e arsimit të lartë, shumë institucione të arsimit të lartë në vendin tonë, fragmentizon numrin e studentëve që duan të ndjekin arsimin e lartë në IAL jo publike.
- 2) Kurrikulat që ofrojnë universitet e tjera në vendin tonë janë të ndryshme nga ajo e ofruar nga UNYT për programin e studimit Bachelor në Psikologji, pengon mobilitetin e ndërsjellë të studentëve.

**e. Rekomandime:**

- 1) Institucioni të shohë mundësinë për të rritur numrin e studentëve që regjistrohen në këtë program studimi.
- 2) Institucioni të shohë mundësinë për të rekrutuar staf të ri akademik me grada dhe tituj të specializuar në fushën e psikologjisë.
- 3) Institucioni të realizojë një studim tregu me qëllim vlerësimin objektiv të nevojave të tregut të punës për psikologë, çka do të sillte edhe një parashikim të mundshëm për nevojën e hapjes së programeve të ciklit të dytë të studimit, me qëllim sigurimin e vijimësisë së studimeve për studentët e këtij programi studimi.
- 4) Institucioni të shoh mundësinë e parashikimit në syllabus të modaliteteve për ndarjen e orëve të dedikuara për seminare dhe leksione.



## SUMMARY ANALYSES OF THE STUDY PROGRAM EVALUATION

### **I. ANALYSIS OF FULFILLING THE RECOMMENDATIONS GIVEN BY THE ACCREDITATION BOARD IN THE DECISION OF THE FIRST ACCREDITATION**

The External Evaluation Group noted that regarding the first recommendation, increasing the number of students, University has made different efforts, but this number continues to be low, so this recommendation is not fulfilled.

Regarding the second recommendation, increasing the number of partnerships with practitioners of the psychology, University has increased this number of these partnerships from the last accreditation, concluding that this recommendation is fulfilled.

### **II. SUMMARY ANALYSIS OF EXTERNAL EVALUATION GROUP BY SWOT METHOD (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats).**

#### **a. Strengths:**

- 1) The academic staff of this study program is qualified and has experience in teaching and in the field of psychology.
- 2) University of New York Tirana has an effective partnership with New York State University (SUNY) and issues a double degree/diploma with this university.
- 3) New York University Tirana has active cooperation agreements with entities that guarantee quality education for textbooks such as the McGraw-Hill International Publishing House and others such as ERASMUS +.
- 4) New York University Tirana is committed to ensure international and national standards for teaching process and qualifications of students, which are all documented in policies and strategies.
- 5) UNYT has the right to use the software that detect plagiarism Turnitin, promoting academic honesty and scientific research by both students and academic staff.
- 6) Study Program Bachelor in Psychology presents flexibility for graduate students to compete for further specialization in international universities.

#### **b. Weaknesses:**

- 1) The study program Bachelor in Psychology has limited number of students
- 2) Academic staff teaching psychology subjects is limited.
- 3) The study program is not based in analyzing the market demands for psychologists.
- 4) UNYT do not offer continuity of qualifications in advanced study programs such as Master of Professional Studies or Master of Science for the graduated students of this study program.
- 5) The mobility of students in other Albanian universities in is not applicable due to curricula and teaching structure.
- 6) The actual study program curriculum foresees a considerable number of credits for general subjects and does not foresee the separation of teaching lessons into lectures and seminars



**c. Opportunities:**

- 1) Teaching in English language can be attractive for students from different countries in the region and beyond.
- 2) The University has important cooperation agreements, such as McGraw Hill, ensuring the usage of the most recent study literature and textbooks.
- 3) University of New York Tirana has potential resources to offer master study programs to ensure continuity of studies for students graduated from this program.
- 4) Increasing the cooperation agreements with institutions providing psychological services would enable students to be more exposed to labor market demands and better orient themselves to profile their qualifications.
- 5) Partnership with SUNY offers good opportunities to reorganize effectively the curricula and credits of psychology specialty subjects, within the allowed norm (20% each academic year).

**d. Threats:**

- 1) The competition in higher education sector, high number of universities in Albania, diffuse the number of students that want to be educated in private universities.
- 2) The Curricula that is offered in other Albanian universities is different from the one offered from UNYT for the study program Bachelor in Psychology, which prevents the mobility of students.

**e. Recommendations:**

- 1) The university should see the possibility to use different approaches to increase the number of students enrolled in this study program.
- 2) The university should see the possibility to recruit new academic staff with academic degrees specialized in the field of psychology.
- 3) The university should see the possibility of carrying out a market study, which will result in objective assessment of labor market needs for psychologists. This would also provide a clear view if there is a need for opening advanced study programs in order to ensure the continuity of studies for students of this program.
- 4) The university should see the possibility of adapting syllabuses to foresee modalities for allocating dedicated hours to seminars and lectures.

**External Evaluation Group**

1. Prof.As.Dr.Artemisi Shehu
2. Dr.Esmeralda Ismaili

